



FKPKK

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Shqipëri

www.shkpkk.org

# Kurora e Gjelbër



APPK

Asosacioni i Pronarëve të Pyjeve Privatë, Kosovë

www.akppp.org

Gazetë Periodike, Tiranë (Viti i katërbëdhjetë i botimit) Nr. 115, prill 2012 Çmimi 20 lekë

## Fermeri është pronar i pyllit të tij

(Çdo tentative për të vazhduar mbajtjen peng të pyllit të tij do të thotë vazhdim i shkatërrimit)

Vijon nga numri i kaluar

**M**enaxhimi i Pyjeve është përgjegjësi e familjeve, fshatrave e komunave, por edhe e qeverive apo autoriteteve globale. Kjo thuhet e pranohet pothuaj nga të gjithë, por në realitetin tonë duket si parullë boshe. Roli politik apo vendimmarrës i qeverisë, si përgjegjëse për të menaxhuar shtetin në këtë udhëkryq ku kanë arritur pyjet, mbetet kritik. Vendimet mund të thellojnë impaktet negative ose të krijojnë vlera të reja e të gjithanshme kombëtare. Kërcënimet e katastrofës mjedisore po pasojnë njëri-tjetrin. Zëri po ngrihet që nga fshatarët, që organizohen për të mbrotur pyllin e tyre, duke i kërkuar qeverisë ta shpallë Park Kombëtar, si në rastin e Shebenikut, e deri në punimet e Asamblese Ndërkombëtare të Tokës, që u mbajt vitin e kaluar në Tiranë.

Shumë artikuj, emisione e filma janë prodhuar e kanë dokumentuar humbjen e pyjeve, pasuar me shumë kërcënime - nga fermerë, barinj, projekte e organizatat ndërkombëtare autoritare.

Situata aktuale e shton barrën mbi qeverinë, që nuk e delegoi menaxhimin e kësaj pasurie shumë të rëndësishme, ashtu siç u angazhua me ligjin e parë të pyjeve, pas rrezimit të sistemit të kaluar, para popullit të saj e partnerëve ndërkombëtarë për përdorim të qëndrueshmë të këtyre resurseve. Me ligjin e pyjeve të vitit 1991, ligjvënësit dhe qeveria shqiptare në nenin 4 të tij u zotuan t'i japin fermerit në përdorim 0.4 deri 1 ha pyll për çdo familje. Kjo u legalizua me Rregulloren 308, të firmosur nga ministri i Bujqësisë me 26 janar 1996, ku miratohej dhënia me

kontratë me përdoruesin e pyllit. Ligji tjetër i pyjeve, i vitit 2005, e hoqi këtë nen, duke shfuqizuar pa asnjë bazë ligjore me mijëra marrëveshje me komunat apo kontrata të komunave me fermerët, që kishin afat 10 vjeçar. Nën presionin e shoqatave, Këshilli i Ministrave nxori Vendimin e qershorit 2006, ku u ngarkohet detyrë qarqeve e komunave për të regjistruar përdoruesit e pyjeve. Ishte po qeveria që më pas nga "dhënie në përdorim të komunave" e ndërroi termin në "dhënie në pronësi". E gjithë kjo "lojë pingpongu" bëhet gjoja pasi qeveria dhe ekspertët e saj nuk kanë siguri të pronarët për ruajtje, ashtu siç kishte frikë qeveria e para 1990-ës, që t'i jepte fermerit blegtorinë dhe tokën, tani qeveria ka frikë t'i besojë pyllin e tij. Por, në fakt, e gjithë kjo, bashkë me politikat e ligjet e hartuara po

prej qeverive të 20 viteve të fundit, ka çuar në shkatërrime katastrofike, që aktualisht janë në prag të moskthimit e rehabilitimit për një pjesë të madhe të terrenit.

Ekspertë, pjesëmarrës në hartimin e ligjit të vitit 1991 dhe të strategjisë së vitit 1998, me ndihmën e USAID-it, apo të gjithë krahurës së ligjeve e vendimeve kontradiktore, kërkojnë që tani, pas 20 vitesh investime, të fillojnë edhe njëherë lojën nga fillimi e të bëjnë një studim se si e kanë vendet e tjera. Në fakt ky studim është kryer. Harta me 252 komuna, ku janë bërë planet e menaxhimit, me financime të Bankës Botërore e janë identifikuar përdoruesit e pyllit dhe kufiri i pyllit të fshatit, është mjaft e saktë dhe e qartë. Fshati i ka kufijtë. Ka edhe dy komisione, atë që ndau tokën

Vijon në fq. 2

## PËRVOJË SHËRBIMI KËSHILLIMOR

Prof. Dr. Tatjana DISHNICA **PUBLIK NË BUJQËSI**  
Drejtoresh e Shërbimit Këshillimor dhe Informacionit Bujqësor në MBUMK



**P**rocesi drejt integrimit evropian të vendit tonë, vë përballë sfidash të mëdha e të vështira edhe sektorin e bujqësisë dhe ushqimit. Liberalizimi i tregjeve, shoqëruar me rritjen e konkurrencës, kërkesat për produkte cilësore e të sigurta, nevoja për komercializimin e fermave, etj., nuk mund të përballohen pa zhvillim teknologjik të shpejtë e të qëndrueshëm. Në këtë vështrim, gjenerimi, përshtatja dhe transferimi i teknologjive të reja tek fermerët ka rendësi themelore. Zhvillimi i teknologjisë dhe transferimi i saj është proces kompleks, që kërkon koordinim, marrëdhënie të qarta dhe

mekanizma lidhës ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë në këtë sistem.

Në vendin tonë, shërbimet këshillimore dhe të ekstensionit funksionojnë në kuadër të një sistemi me aktorë të shumtë (shërbimet publike, OJQ, projekte të financuara nga donatorë etj.). Shërbimi këshillimor publik, në nivel qendror organizohet dhe drejtohet nga MBUMK, Drejtoria e Shërbimit Këshillimor dhe Informacionit Bujqësor, e cila është përgjegjëse për strategjinë, menaxhimin, organizimin dhe koordinimin e këtij shërbimi në shkallë vendi. Ky shërbim ofron këshilla dhe shërbime të ekstensionit bujqësor, tek fermerët, nëpërmjet strukturave rajonale.

Në strukturën e DRB-ve, në nivel rajonal, ushtrojnë aktivitetin e tyre, 12 Sektorë të Shërbimit Këshillimor. Në përputhje me specifikat e çdo rajoni, çdo sektor i këshillimit bujqësor në rajon, ka 3-4 specialistë të profilizuar (hortikulturë, mbrojtje bimësh, zooteknik dhe ekonomist). Numri total aktual i të punësuarve

Vijon në fq. 2

## PYLLTARIA NË KOSOVË

# Vendimmarrja për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve

Nijazi IDRIZI

Deputet në Kuvendin e Kosovës

**V**endimmarrja, si për të gjithë sektorët, vlerësohet tepër e rëndësishme për të ardhmen e pylltarisë. Ajo varet pothuaj tërësisht nga të dhënat dhe mundësia e shndërrimit të tyre në informata. Vetë grumbullimi i të dhënave në sektorin e pylltarisë është i zorshëm, për shkak të sipërfaqeve të mëdha me pyje. Për më shumë, këto të dhëna duhet të specifikohen, jo vetëm sipas karakteristikave të produkteve që prodhojnë pyjet, por edhe sipas mundësisë së menaxhimit të tyre. Këto të dhëna janë

ndërsektoriale dhe përfshijnë shumë aktorë, të cilët në të shumtën e rasteve kanë interesa të ndryshme. Ndosht shpesh që të dhënat mbi pyjet, për shkak të intereseve të ndryshme, nuk favorizohen që të shndërrohen në informata, për të



Vijon në fq. 5

## DEBAT Pylli i fermerit ka zot fermerin

Përgatiti inxh. Malvina SHEHI

**P**as botimit të artikullit me këtë titull dhe shënimit të kryetarit të FKPKK, Rexhep Ndreu, në postën elektronike ka nisur një debat, ku hidhen mendime, shkëmbehen përvoja dhe bëhen diskutime e propozime nga specialistë ekspertë të pyjeve, pylltarë me përvojë e mjaft prej atyre që e kanë lidhur jetën me pyjet. Një përmbledhje të të cilave po e sjellim në vazhdim.

**Rexhep Ndreu.** Një nga ndryshimet më të mëdha të dy dekadave të fundit është edhe kthimi i pronës private. Për administrimin, transferimin dhe pronësinë e tokave bujqësore e pyjore ka ligje të ndryshme. Shumë persona pretendojnë se në fshat kanë një sipërfaqe të madhe toke me pyje apo kullota. Ata nuk kanë tapi dhe dokumente, por meqë i kanë përdorur tradicionalisht nga brezi në brez, tani i quajnë prona të tyre dhe banorët vendas ia njohin njëri-

tjetrit këto sipërfaqe. Pas viteve 1990, kufijtë e pasurive të paluajtshme u bënë problem shoqëror. Ato në vëmendjen e komuniteteve tashmë kërkonin një vlerësim të plotë për të ndaluar konfliktet dhe mosmarrëveshjet. Rikthimi në



traditë, duke njohur apo rivendosur kufijtë nga pleqësitë (kryesitë) e fshatrave, pa ndërhyrjen e organeve shtetërore, për pyjet e kullotat, pati një ndikim pozitiv, pasi megjithëse të degraduara dhe me prodhimtari të ulët, tani filluan të vihen nën kontroll, për të ndaluar prerjet dhe kullotjen pa kriter për të mundësuar ripërtëritjen e tyre. Këtë përmirësim të pyjeve mund ta shohim dukshëm pothuaj në të gjitha pyjet afër fshatrave, në luginën e Kirit e të Shalës, të Matit, Drinit të Zi, Shkumbinit e të tjera e të tjera.

**Genci Pina:** Përsëritje kolegë! Unë mendoj se defakto kjo nuk do të realizohet kurrë, mbasi ata "çapkenët" dhe "të fortët" nuk kanë lënë gjë për fshatarët (fermerët). I kanë hipo-

Vijon në fq. 3



# Fermeri është pronar i pyllit të tij

Vijon nga fq. 1

bujqësore dhe atë të pyjeve. Për çdo fshat është bërë dhe firmosur marrëveshja me fshatrat kufitare dhe është miratuar në këshillin e komunës. Vendimi është konfirmuar edhe nga çdo prefekturë. Të dhënat janë si në Njësinë e Projektit, ashtu edhe në Ministrinë e Mjedisit. Janë mbi 20 raporte të BB, që u janë dërguar çdo 6 muaj minsitrit të Bujqësisë para vitit 2006, duke kopjuar gjithmonë Ministrinë e Financave. Në të gjitha raportet është përmendur ecuria e identifikimit të perdoresve dhe vendosjes së kufijve të fshatrave apo komunave.

Pas 20 vitesh janë prodhuar shumë e shumë harta, disponohen të gjitha procesverbalet, vendimet e komunave e miratimet e tyre dhe duket e çuditshme që qeveria kërkon të nisë nga fillimi për të gjetur platformën, pasi nuk ka informacionin e nevojshëm lidhur me platformën e privatizimit. Kjo i ka habitur shtëpërimi donatorët dhe mund të vërë në pikëpyetje projektin në vijim, që është pikërisht për të vazhduar praktikën e mirë, të nisur për të rehabilituar pyjet e plotësuar të drejtat bazë njerëzore të fermerëve.

## Mbi 10 mijë anëtarë të komisioneve të Pyjeve në fshatra i kanë kaktuar kufijtë e pyllit të fermerit

Në një hapësirë kohore rreth 18 vjeçare, partnerët tanë strategjikë ndërkombëtarë, si BB, USAID, qeveria italiane e ajo zvicerane, Sida, SNV, FAO, na kanë asistuar për të ndaluar katastrofën ekologjike e për të gjetur një model për ringjalljen e mbulesës pyjore, si burim i ripërtëritshëm natyror. Vetëm në sektorin e pyjeve, pa përmendur mjedisin në përgjithësi, kjo asistencë teknike, e shoqëruar me investime dhe reforma të projektuara, i kalon 50 milionë dollarë.

Rregullorja e Ministrisë së Bujqësisë e vitit 1996 kishte si bazë përfshirjen e përfaqësuesve të fshatrave e komunave në krah të Shërbimit Pyjor, për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të pyjeve e kullotave. Në zbatim të saj e me financim të BB e qeverisë shqiptare, janë ngritur komisionet e pyjeve dhe kullotave në çdo fshat të vendit. Objektivat e projekteve të përkrahur e implementuar nga qeveritë kanë qenë planifikimi me pjesëmarrje, pranimit e konstituimi i së drejtës së përdorimit, si dhe zbatimi i punimeve nga vetë komunitetet lokale, duke evituar tenderët e duke rritur kapacitetet dhe dijet e banorëve lokalë.

Në platformën që qeveria po kërkon për të privatizuar pyjet, i duhen kujtuar të gjitha këto investime të bëra po prej saj, me asistencë



ndërkombëtare. Qeverisë i duhet kujtuar që ajo ka mbështetur legalisht e financiarisht dhe ka arritur që sot në shkallë vendi janë ngritur e dokumentuar mbi 2500 komisione të pyjeve e kullotave me rreth 10 mijë anëtarë, komisione që janë zgjedhur në çdo fshat e komunë, kanë marrë pjesë dhe kanë rënë dakord me fshatrat kufitare për kufirin e pyllit e të kullotës së tyre. Shteti ka investuar nëpërmjet donacioneve ndërkombëtare dhe Agjencia Suedeze për bashkëpunim ndërkombëtar, në bashkëpunim me SNV, kanë realizuar programe për t'i trajnuar këto komisione për të bërë regjistrimin e kufijve të fshatrave, si dhe me njohuritë themelore për menaxhimin e qëndrueshëm të pyllit të fermerit.

Federatat Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale është ombrella, por edhe lokomotiva, që i përfaqëson jo vetëm në shkallë kombëtare këta dhjetë mijë komisionerë, 250 shoqata e 10 federata rajonale, por ajo është edhe anëtare e Federatës Evropiane të Pronarëve Privatë të Pyjeve, si dhe anëtare e partne-

re e koalicionit ndërkombëtar të tokës, që siç thamë, e mbajti asamblenë e fundit ndërkombëtare në Tiranë. Ajo është partnere kryesore e donatorëve në projektet për rritjen e kapacitetit të fermerëve, si për menaxhimin e pyllit, ashtu edhe të kultu-rave arrore.

## Projekte ndërkombëtare 17 vjet të zbatuara, po të pakuptuara nga opinioni, media e politikëbërësit

Diku nga mesi i viteve 1990, Banka Botërore, USAID e donatorë të tjerë, të shqetësuar nga degradimi me ritme alarmante, hartuan e zbatuan disa projekte, të cilët në shumicën e tyre, kur u realizuan në bashkëpunim me banorët lokalë, rezultuan në një kohë relativisht të shkurtër me rehabilitim të bimësisë dhe shtim të interesit të fermerëve për t'u kujdesur. Kjo u shoqërua edhe me emërtime, si "projekte për pylltarinë komunale", emërtim që coincidoi edhe me riorganizimin e pushtetit lokal e organizimin e disa fshatrave në komuna. Emërtimi krijoi një konfuzion nëse ishin projekte me komunitetin apo komunën. Komuna, meqë ishte njësia bazë e organizimit lokal, shpesh u duk edhe si mbar-tëse. Në vitet e tashme, kur pyjet e larta u dorëzuan, nga prerja masive e pasuar me djegie, qeveria tentoi të reflektojë, që të hiqte nga vetja barrën e rëndë dhe akuzën si shkatërruese e pyllit, duke tentuar të transferojë një pjesë të madhe të komunat. Një kategori e re edhe kjo e paligjëruar dhe pylli në ngritje është vënë nën trajtimin e ish-kujdestarëve; ai vazhdon të rritet shpejt, duke dhënë shpresa. Por ka hapur edhe një debat të përqendruar jo tek analizat, por te fakti se kujt i takon ky pyll, e kujt është pronësia e tij, e shtetit, e organeve lokale apo e familjeve.

## Media duket larg problematikës reale të pyjeve e mjedisit

Praktika 20 vjeçare e transferimit të pyjeve drejt komunave, fshatrave apo familjeve, u kalua me pak raste në heshtje nga mediet. Në pak raste ambasada e SHBA bëri promovim të transferimit të pyllit te fshati, si në Kallmet apo në Bubq, dhe më pas me qindra mbledhje për të ndarë pyllin në mes fshatrave apo për të kualifikuar përdoruesit e pyjeve, kanë kaluar thuasj në heshtje. Asnjë nga këto s'përbente lajm për median. Vetëm prerja e drurit. Media, bashkë me shoqatat mjedisore, janë ushqyer me të pavërteta dhe ëndërojnë që këtë tokë ta shohin si një muze, që të qëndrojë ashtu si një rezervë natyrore statike, muze që të mos menaxhohet. Ndërkohë, banorët kanë nevojë, tregu po ashtu. Nëse futet në sistem menaxhimi, prerja është e dobishme për të nxitur rritjen. Druri prodhon

energji të rinovueshme; kjo e ka kthyer atë në qendër të vëmendjes edhe për shtetet evropiane, që kishin vite që e përdornin për industri e letër, peizazh e biodiversitet. Përgjithësisht shkolla, media, politika dhe institucionet menaxhuese të tokës, nuk kanë bërë asnjë përpjekje serioze për të kuptuar në thellësi raportet historike të komunitetit me tokën. Rregullat që janë krijuar që nga prehistoria, të fiksuara në kanune, që ndanin të drejta e përgjegjësi, përgjithësisht janë përbuzur si joshkencore e folklorike.

Ekspertët e diplomuar dhe popullsia janë aktualisht në një konfuzion të plotë. Djemtë e fermerëve, që bëhen politikanë, gazetarë apo pylltarë, nuk e kuptojnë tokën që i ka mëkuar dhe kanë çorientuar të gjithë opinionin. Mediet, ashtu si edhe shoqatat mjedisore, mjaftohen me parullat me origjinë osmane, "mos prisni pyjet", pa tentuar të analizojnë që i gjithë ky territor nuk ka akoma rregulla të qarta të të drejtave e përgjegjësi, për pasojë, është jashtë administrimit. Jashtë-administrimi apo administrimi spontan çon në degradim. Media, bashkë me politikën, as që e kuptojnë që eksperti dhe asistencë financiare bëhen të panevojshme për një sistem nga i cili nuk kërkohet prodhim. Për të gjithë opinionin publik prerja e drurëve, pa e bërë dallimin ku dhe për çfarë, pa ditur që prerja është formë e menaxhimit, aktualisht trajtohet si kasaphanë. Askush nuk e sqaron kontekstin prerje, ku për çfarë, e shoqëruar nga se, për të arritur ku. Sepse të gjitha këto mungojnë.

## Përse mbetet jashtë menaxhimit 40 % e tokës shqiptare

Ky territor i abandonuar ka potencial të shtojë deri 50 % të ardhurat nga ferma agropjore. "Pylli për popullin", deklaroi OKB. "Pylli për popullin", deklaroi qeveritarët. Viti Ndërkombëtar i Pyjeve sapo u festua. Por, pylli shqiptar është vënë kundër popullit. Që të bëhet pylli për popullin, së pari duhet kuptuar koncepti, lidhja shekullore e popullit me pyllin. Pastaj duhet pranuar që i gjithë sistemi i shkurreve apo dushkajave, në 30 vitet e fundit është jashtë çdo sistemi menaxhimi, në shkatërrim të pandalur spontan. Asnjë strategji nuk e analizoi kurrë sistemin tradicional se si sigurohej kullota e druri i ngrohjes, se si i merrej maksimumi tokës kodrinore e malore, duke e mbrojtur njëkohësisht atë nga gërryerjet.

Zabeli, Kashnjeti, Prozhma, Korja, Mali, kanë qenë historikisht fermta pyjore të malësorëve shqiptarë, që në zonat malore e kanë pasur shumë të kufizuar tokën bujqësore. Kjo praktikë e pasur shumëvjeçare nuk njihet dhe, çuditërisht, kundërshtohet nga shkollat py-

Vijon në fq. 3

## SHËRBIMI KËSHILLIMOR PUBLIK NË BUJQËSI

Vijon nga fq. 1

në këtë shërbim është 270, prej te cilëve 210 operojnë në nivel terreni (120 në qendra të informacionit bujqësor dhe 90 direkt në terren). Këto 120 qendra, fillesat e të cilave datojnë vitin 2002, janë të shpërndara në zonat më të rëndësishme të prodhimit bujqësor dhe kanë për detyrë të ofrojnë për fermerët, por edhe për agrobiznesin, informacion mbi teknikat dhe teknologjitë për prodhimin bimor e blegtoral, inpute cilësore, legjislacionin, menaxhimin e fermës, plane biznesi, mundësitë e kreditimit, marketingun e prodhimeve, çmimet dhe tregjet, potencialet prodhuese, mundësitë e përpunimit, prognozë-sinjalizimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, sigurinë ushqimore, etj.

Bazuar në një program vjetor, Shërbimi Këshillimor Publik realizon një sërë aktivitetesh, si: demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, vizita, panairë, ditë tregu, takime individuale, etj. Ky shërbim, nëpërmjet strukturës së tij në nivel qendror, rajonal e komunë, përgatit dhe shpërndan gjate vitit, broshura me karakter teknik, të përgatitura në bashkëpunim me ekspertët të QTTB-ve dhe UB-së, fletëpalosje

me tematika të ndryshme, që reflektojnë nevojat e fermerëve dhe agrobiznesit në zonat rurale, realizon emisione, kronika, në radio-televizione lokale e kombëtare që pasqyrojnë përvoja, aktivitete dhe japin informacione të ndryshme teknike e informuese për fermerët, trajnime për specialistët e shërbimit këshillimor dhe të interesuar të tjerë, kërkime në fermë, në bashkëpunim direkt me fermerët dhe QTTB-të.

Shërbimi këshillimor informon komunitetin e fermerëve për skemat mbështetëse, ndihmon në plotësimin e aplikimeve, hartimin e projekteve të zbatimit dhe gjatë procesit asiston në vazhdimësi për fermerët që fitojnë grante. Janë asistuar nga ky shërbim, 8500 fermerë, që kanë aplikuar për skemat mbështetëse.

Shërbimi i Ekstensionit Publik ka rritur shkallën e bashkëpunimit me ofruer të tjerë të shërbimit këshillimor, siç janë ofruerit publikë (QTTB, Universitetet Bujqësore), ofruerit privatë të shërbimeve, organizatat prodhuese dhe organizatat joqeveritare.

Në nivel qendror e rajonal, është bashkëpunuar me projekte apo fondacione të ndryshme, të cilat kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve të strukturave të ekstensionit publik nëpërmjet trajnimeve, vizitave, përvojave, botimeve të ndryshme, etj.

Në kuadër të IPARD po realizohen trajnime që ndihmojnë në rritjen e njohurive dhe

aftësi teknike të specialistëve të Shërbimit Këshillimor në lidhje me skemat mbështetëse;

Duhet theksuar se Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB-të) dhe shërbimi këshillimor publik, operojnë nën të njëjtën "ombrellë", pra brenda të njëjtës drejtorie, zgjidhje kjo mjaft efektive dhe sipas modeleve të vendeve të zhvilluara.

QTTB-te, në vijim të konsolidimit të profilit të tyre, në përgjigje të nevojave të fermerëve, ofrojnë teknologji të përmirësuar apo elementë të veçantë të tyre. Rezultatet e projekteve kërkimore janë pasuar nga një numër i madh demonstrimesh, të realizuara në vijim me pjesëmarrjen e fermerëve të interesuar.

Mungesat në teknologjinë e informacionit, kanë vështirësuar rolin e aktoreve të ndryshëm, duke kufizuar kontributin e kërkimit dhe ekstensionit në zhvillimin e bujqësisë.

Për këtë arsye, kohet e fundit MBUMK (Drejtoria e Shërbimit Këshillimor dhe Informacionit Bujqësor), ka ngritur Platformën "Rrjeti për inovacion, kërkim dhe këshillim" nëpërmjet një web: [www.agro.al](http://www.agro.al)

Platforma, inkludon një rrjet kërkimi dhe ekstensionit, për të aftësuar fermerët dhe popullsinë e zonave rurale, drejt kërkesave të tregut, diversifikimit të të ardhurave, mbrojtjes së mjedisit dhe adaptimin ndaj ndryshimeve

klimatike. Ky rrjet, në të cilin ftohen të marrin pjesë gjithë aktoret e interesuar, përben një mjet mjaft efektiv për shkëmbimin e informacionit dhe përmirësimin e përfshirjes të tërë aktorëve kryesorë në procesin e këshillimit në bujqësi. Ai "zvogëlon distancat" midis ekstensionistëve dhe kërkuesve dhe siguron një prezencë "virtuale" të kërkuesve për të interesuarit. Gjithashtu rrit ndjeshëm mundësinë për të ofruar informacion të shumëllojshëm nga çdo aktor i interesuar, duke e përqendruar këtë informacion, në një portal të vetëm.

Kjo Platforme, konsiderohet një VERCON-like. VERCON (Rrjeti i komunikimit virtual të ekstensionit dhe kërkimit) është një model konceptual, që çdo vend mund ta ngrejë dhe përshtatëse për të përmirësuar aksesin për informacion bujqësor e shkëmbimin e njohurive, për të forcuar lidhjet midis aktorëve të zhvillimit rural, duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.

Funksionimi i një modeli të plotë VERCON, kërkon infrastrukturën përkatëse. Në sistemin tonë të këshillimit bujqësor, kjo infrastrukturë ka shumë mangësi, sidomos në nivelin e qendrave të informacionit bujqësor. Për këtë arsye, hapi i parë është ngritja dhe funksionimi i një VERCON-like, më pas do të kalojmë gradualisht në modelin e plote VERCON.



**B**esoj se dëshirat pylli ia ka shprehur druvarit. Për këtë arsye, dua të bëj disa komente dashamirëse. Para se të komentoj dëshirat, dua të bëj disa shpjegime e analiza për kuptimin e fjalëve “Druvar” dhe “Pyll”. Fjala druvar përdoret tek ne kryesisht për të thirrur shfrytëzuesin e pyllit. Kjo fjalë në anglisht thuhet “Woodman” (fjalë për fjalë “burri i drurëve”), italianët e thërrasin “Boscaioilo”, ruset “Lesorub” apo “Lesnik”, francezët “Bûcheron”, e kështu mund të numërohen shumë. Amatorë e dashamirës të pyjeve në Angli (Ben Law 2003) e komentojnë fjalën Woodman, jo në kuptimin e drejtpërdrejtë (“burri i pyllit”), por në kuptimin e saj të prejardhur nga latinishtja “wood mano”, që në shqip ka pak a shumë kuptimin “duart e drurit”. Një koment i tillë duket se i bëhet kësaj fjale gjerësisht të përdorur, për të hedhur dritë mbi lidhjen e thellë e të lashtë të njeriut me drurët e pyllin, duke u konsideruar vetë njeriu si dorë e pyllit. Është fakt i padiskutueshëm që njeriu e lidh ekzistencën me strehën dhe ushqimin, që i ofroi pylli. Thënë ndryshe, raporti drurë - njeri ka qenë jetik për njeriun.

Në fakt, ishte druri që e populloi i pari globin, miliona vite me vonë, pasi kishte duruar me

dhjetëra kafshë të tjera, që i pengonin ripërtëritjen, por nuk e digjnin e as nuk e prisnin, deri sa erdhi edhe njeriu. Në hapat e parë mbi tokë, njeriu e përdori si strehë, duke u ngjitur në kurorën e tij sa herë i shfaqej ndonjë nga gjitarët e mëdhenj që e kërkonte si burim ushqimi. Më pas njeriu zbuloi zjarrin, të cilin shpejtoi ta përdorte pa kursim edhe kundër pyllit, për ta nënshtruar e zvogëluar atë, por edhe për ta shndërruar në kullotë apo për të mbjellë kultura bujqësore. Druri u mësua me njeriun, dalëngadalë po kuptonte që, duke qenë i dobishëm për të, njeriu vërtet e rriste apo e digjte drurin e rritur, por ama kujdesej për filizat, që dilnin nga fara apo vendi ku pritej. Edhe fiziologjia e drurit duket se iu përshtat njeriut, ndoshta për hir të tij, apo i detyruar prej tij, druri filloi që krahas shumëzimit seksual, të përshtatet edhe për shumëzimin vegjetativ, me anë të sythave, duke i mbajtur në gatishmëri e duke i çelur këto sythe menjëherë pas prerjes, çka i mundëson të rritej më shpejt.

Fillimisht me jetë pothuaj më të gjatë se njeriu, druri i përshtatur prej tij, filloi të rritej më shpejt e brenda jetës së njeriut të qarkullojë disa gjenerata, me drurë më të vegjël e të rinj, që priteshin sipas nevojave e

# Dëshirat e pyllit

HAKI KOLA

përmasave që i duheshin njeriut. Kjo kategori drurësh, e përshtatur për t'i shërbyer njeriut, duke ruajtur rrënjët e drurit të lashtë, që kishte lindur natyra. Grumbulli i drurëve, formuar për të plotësuar nevojat e njeriut, nuk kishte pothuaj asgjë të ngjashme me atë që në përkufizimet zyrtare e quajnë pyll. Vetë fjala kuptohet e interpretohet ndryshe nga banorët ruralë e ndryshe nga ata urbanë. Përgjithësisht malësorët shqiptarë e përdorin rrallë fjalën pyll, për ta është më e zakonshme fjala mal, se sa ajo pyll. Në regjistrat kadastrale pyjet në Kosovë janë të shënuar nën emrin mal. Nëse fjala pyll përgjithësisht nënkupton një grumbull me drurë të lartë e të drejtë, të krijuar përgjithësisht nga natyra, me jetëgjatësi mbi një apo disa shekuj, grumbulli i drurëve i pranishëm në vendbanime e i trajtuar që në lashtësi nga njeriu në zonat të ndryshme të vendit tonë, trajtohet herë si pyll i ulët e herë si kullotë me drurë që krasiten, duke u thirrur përgjithësisht në varësi të funksioneve apo zonave, prozhëm, zabel, hamalle, kashnjat, korie, etj.

Përdorimi i një emri të vetëm, PYLL, për këto dy ekosisteme, me prejardhje, sisteme silvikulturore e menaxhimi esencialisht të ndryshme, shpesh krijon keqkuptime për opinionin publik, institucionet, mediat, madje shpesh edhe ndërmjet vetë ekspertëve të pyjeve. Jo vetëm në Shqipëri, por pothuaj të gjitha shkollat pyjore në Evropë, i njohin të dyja këto kategori me një emër të vetëm, pyll, që nga viti 1808, kur edhe kullotat me drurë u përfshinë në këtë klasifikim.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm, ka mundësi që edhe “Dëshirat e pyllit” të jenë të ndryshme për këto sisteme të ndryshme. Duket që zabeli, prozhma, ograja, korija, kanë dëshira relativisht të ndryshme, me pyllin e lartë të ahut, hormoqit, pishave apo bredhave. Por kjo nuk i pengon në një dëshirë të përbashkët, ashtu si edhe gjithë qeniet e tjera të planetit. Dëshirë e përbashkët e të dy kategorive do të ishte lënia e pasardhësve sa më të shumtë, në duar e me të ardhme të sigurt. Si pylli me cikël të shkurtër prodhimi, edhe ai me cikël të gjatë, pavarësisht dëshirave tona, ashtu si edhe

qeniet e tjera të gjalla, s'mund të jenë të përjetshëm. Përkundër ëndrrës për përjetësi, ia vlen që garancia për ripërtëritje të jetë dëshira më e madhe. Ndoshta dëshirat vijnë edhe nga iluzionet, halorët me mosndryshimin e ngjyrës gjatë gjithë vitit e krijojnë imazhin e përjetësisë, ashtu siç krijon dushku e ahu, bashkë me gjetherënësit e tjerë, idenë e rilindjes me rrëzimin e çeljen stinore të gjetheve, e të dy këto imazhe ndoshta na çojnë në ato ëndrra. Në mungesë të përjetësisë, mbeten më reale “dëshirat e pyllit” për të pasur pasardhës e kujdestar për t'u kujdesur që pasardhësit të rriten, që mundësisht të bëhen më të mirë se prindërit e për ti lejuar edhe pasardhësit të kenë përsëri e përsëri pasardhës ... Ruajtja e pyllit për mua do të kishte sens nëse njerëzimi do të gjente mekanizmat për t'u kujdesur për filizat e rinj, që i lenë mbi tokë ata drurë që pushojnë së jetuari, filiza që mundësohen të shndërrohen në grumbuj të rritur, dorë për dorë me gjeneratat njerëzore, duke i shërbyer kështu vazhdimësisë së jetës së qenieve të gjalla mbi globin tokësor.

## Fermeri është pronar i pyllit të tij

Vijon nga fq. 2

jore. Për fermerin, krahas shërbimeve mjedisore, kjo është shumë e rëndësishme dhe fermeri është i vetmi që ka dijen dhe e mban këtë sistem. Faktikisht, ajo është pjesë e sistemeve agropjore dhe në rruge natyrore çdo përbërës i agropylltarisë, i shkëputur nga konteksti e i mbetur vetëm, nuk është në gjendje të sigurojë të ardhurat e duhura për fermerin.

Vetëm efekti komplementar midis burimeve të ndryshme të të ardhurave mundëson qëndrueshmërinë ekonomike të fermës së vogël bujqësore të zonave kodrinore e malore.

Është momenti për një reagim e konsensus mbarëkombëtar, si do të emërohet kjo pjesë e mbulesës bimore shqiptare, e cila është pjesë e fermës bujqësore, potencial aktualisht i përdorur. Shkolla pyjore shqiptare ka një sha-

ns për të dhënë një kontribut kombëtar, duke pranuar për të filluar të mendojë të kërkojë dijet atje ku janë, si psh në Francë (Monpelje) apo Angli, ku sistemet silvo-pastorale apo ato të cungishtave kanë histori shumëshekullore. Këto dije është e mundur më pas të përshtaten në kushtet tona ekologjike e social - ekonomike, duke na mundësuar të kuptojmë edhe prejardhjen dhe logjikën e traditave lokale.

Përdoruesit e pyllit të ulët dhe kullotës janë e do të jenë fermerët, sa të vazhdojë të jetë e banuar toka. Është shansi që atë që

Evropa e beri në vitin 1848, ta bëjë Shqipëria pas 164 vitesh. Politikëbërësit e Evropës e ndanë për çdo familje nevojën vjetore për dru për ngrohje, material ndërtimi e kullotje. Janë mbi 15 vjet që edhe tek ne kjo eksperimentohet ashtu si ndërtimi i Kalasë së Rozafës, duke ndërtuar ditën e rrezuar natën. Është koha që kjo odise të marrë fund dhe të fillojë rehabilitimi i tokës pyjore e kullësore në Shqipëri. Kjo është edhe pjesë e kërkesave të Bashkimit Evropian për politikë për tokën.

Korresp. i “Kurora e Gjelbër”

Vijon nga fq. 1

## Pylli i fermerit ka zot fermerin

tekuar të gjitha tokat, pyjet, bregdetin dhe janë “ish-pronarë”, prej kohës së “Baba Qemos”?!

**Spiro Karadumi:** Pylli kryen funksione jo vetëm për pronarin, prandaj duhet ta administrojë gjithë shoqëria. A është në gjendje pronari të mbarështojë pyllin për të gjitha funksionet? Ai nuk ka eksperiencë. Në perandorinë osmane ka qenë sistemi i pronësisë së Timarëve (Histori e Ballkanit - Georges Castellam). Administrimi i pyjeve nga privati ose shteti ka të mirat dhe të këqijat. Duhet menduar mirë zgjidhja, për të mos vazhduar me tej shkatërrimi i pyjeve. Duhet menduar sektori i pyjeve edhe si front pune dhe burim të mirash për të gjithë. Në botë ka shume eksperiencë, por duhet përzgjedhur më e përshtatshmeja. Asgjë nuk është absolute.

**R. Ndreu:** Të falënderoj, Profesor i nderuar ... Por, punuam gjysmë shekulli me sistemin shtetëror të pyjeve pa pronar dhe i sollëm në piken zero ..., a duhet të vazhdojmë të bëjmë prova me pronat e të tjerëve ... Përvoja botërore është shumë e njohur, jo vetëm nga specialistët, por dhe nga fermerët, që po e mbrojnë shumë mirë pronën e tyre. Kur Evropa privatizonte tokën dhe pyjet ne bëmë bunkerë dhe shtetëzonim pyjet ... Prapë do të vazhdojmë kështu ne. Pyjet janë të fshatarëve, që jetojnë në fshat dhe asnjëherë si ka mësuar kush si t'i



përdorin. Tani që ata i kanë marrë pyjet, ne t'i mësojmë si t'i përdorin më mirë ...

FKPKK u bën thirrje të gjithëve të japin modele. Fshatarët na i kanë dhënë modelet dhe u bënë dy dekada që s'po gjejmë modelet më të mirë se të atyre. Prandaj, kush ka modelet më të mira se të fshatarëve le t'i publikojë dhe të shkojmë t'i shohim e po të biem dakord t'i ndjekim, ndryshe të mësojmë bashkë me fshatarët për të përmirësuar modelet e tyre.

**S. Karadumi:** Unë jam pylltar, për pyjet kam studiuar e punuar gjithë jetën, rreth 50 vjet, dhe e shtroj problemin si pylltar; kam marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare mbi formën e pronësisë së pyjeve. Në vende të ndryshme, lindore apo perëndimore, ato janë të ndryshme, edhe sipas kontekstit historik të secilit vend. Unë nuk përjashtoj as njërin as tjetrin formë pronësie, por gjithçka të bëhet mbi studimin e përvojës botërore më të mirë të përshtatur në kontekstin historik tonin. Në kushte specifike

duhet të jetë njëra ose tjetra. Ju uroj punë të mbarë.

**Xhelil Meta:** Edhe unë këtë mendim kam, si Prof. Spiro. Duhet një studim i mirëfilltë dhe jo fushatë, sepse do të krijohen vetëm probleme, jo vetëm të natyrës teknike të menaxhimit të pyjeve, po edhe konflikte sociale. Kjo për vetë faktin se edhe me token ka shume probleme.

**R. Ndreu:** Mendoj se studime kë mjaft. USAID me APFDP benë 20 komuna dhe identifikuan traditat e përdoruesit; PBB në 130 komuna identifikoi përdoruesit dhe traditën; PZHBN identifikoi traditën dhe përdorimin në 240 komuna. Ka studime të Prof. Th. Lako e Prof. V. Muharremaj ... Po ashtu, ne dy numrat e fundit të gazetës “Kurora e gjelbër” botohet një studim shkencor, historik, për pyllin e fermerit ... Këshillat e ekspertëve ndërkombëtarë të BB, SIDA, SNV, ILC, etj., si dhe 200 modelet e pyjeve të fermerëve në rreth 200 mijë ha, nga Shkumbini deri në Vermosh, janë argumente që tregojnë se prona te i Zoti është rruga më e mirë ...

**S. Karadumi:** Më mirë do të ishte të bënit studimin tuaj dhe studimet e mëparshme të rinovohen me situatën aktuale, ndryshimet në pronësinë e tokës, hidrocentralet e ndërtuar dhe ata që parashikohet të ndërtohen, ç'do bëhet me pyjet në basenet e tyre? Po në raste epidemish apo zjarresh, i përballon privati punimet emergjente, etj. Ato studime janë pak të vjetruara, bëni tuajin dhe pastaj veproni.

**R. Ndreu:** Profesor, Gazeta “Kurora ...” në numrat 114 e 115 ka një studim historik dhe shkencor për traditat në këtë fushë. Studime të

kryera që nga viti 2008, mbajnë vulën e Shoqatës Kombëtare dhe janë kryer nga profesorët e nderuar V. Muharremaj e Th. Lako. Studimi i traditave bërë nga Shoqata Kombëtare e hartuar nga ekspertët Pashk Prendi, Prof. Lako e H. Kola ... Ka 5 vjet që ne kemi 200 sipërfaqe prove të përhershme në rreth 200 000 ha pyje të privatëve ku rritja ka shkuar 4-15 m<sup>3</sup>/ha. Në raste epidemish dhe zjarresh, krahas fermerit ka dhe një shërbim të specializuar, për këshillim dhe ekspertizë, Shërbimi Pyjor Shqiptar, që është mbështetës për të gjithë pronarët, për shtetin, që menaxhon DSHP, të komunës dhe të privatit ...

**Pal Çoku:** Debati për pronësinë në pyje lypset të përfshijë sa më shumë faktorë, sepse jemi në një moment që do të jetë vendimtar, jo vetëm për të ardhmen e pyjeve po edhe për të ardhmen e fëmijëve tanë. Suedezët, shumë vite më parë u gjenden në një moment që shteti nuk po funksiononte mirë dhe, për pasojë, dëmet në pyje qenë të pallogaritshme. Për këtë arsye ata vendosën që pjesën më të madhe të pyjeve tua shpërdanin fermerëve privatë. Ky hap i shpëtoi pyjet e Suedisë dhe i solli në atë gjendje që janë sot. Në të njëjtat kushte gjendet vendi ynë sot. Nga përvoja ime në komunën Ulëz them me bindje se fermerët kanë ruajtur traditën e menaxhimit të pyjeve dhe të territorit rreth shtëpisë se tyre, aty ku ata pretendojnë se janë pronarë, ndërsa pjesa tjetër, në pronësi të komunës apo të shtetit, shihet si mall pa zot. Për fat të mirë Shqipëria ka shumë pyje dhe unë mendoj se duhet të ekzistojnë të tri format e pronësisë dhe mbi të tri format, duhet të ngrihet

Vijon në fq. 7



# AKPPP, kontribuese për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bjeshkëve të Namuna

nga Ardita DINAJ



**D**isa nga Shoqatat e Pronarëve Privatë të Pyjeve të Rajonit të Pejës ishin pjesëmarrëse në trajnimet e organizuara nga Organizata Mjedisore ERA, në kuadër të programit për zhvillim të qëndrueshëm alpin, program i mbështetur nga SIDA-SNV.

Në mënyrë që të ndërtohen kapacitetet e iniciatorëve potencialë dhe për ngritjen e njohurive e të kuptuarit e implementimit praktik për iniciativat e qëndrueshme zhvillimore në zonat rurale apo rajonet alpine, "ERA" hartoi një program trajnimi 5 ditor me pjesëmarrës nga shoqata e Pejës, Deçanit e Junikut. Në këtë trajnim ata mësuan për praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm, punuan në grupe

rreth ideve të projekteve të tyre, me të cilat aplikuan përmes thirrjes së hapur, bashkëpunuan mes grupeve pjesëmarrëse në trajnim ... Shoqatat e Pronarëve të Pyjeve Private nga Peja, Deçani e Juniku kanë tashmë zyrat e tyre dhe funksionojnë me aktivitetet e parapara me plan. Ato kanë fituar mbështetje edhe me herët nga SIDA-SNV për iniciativat dhe angazhimet e tyre rreth çështjeve prioritare të pronarëve të pyjeve. Kështu, Shoqata e Pejës është angazhuar në studimin e pronave kontestuese pyjore në trevat e Rugovës, ndërsa Shoqata e Deçanit është angazhuar në mënyrat dhe metodat e lobimit me rastin e hartimit të ligjit të ri të pyjeve, projekt i zhvilluar në

kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar. Kurse shoqata e Junikut është angazhuar në ngritjen e vetëdijes së fëmijëve dhe shtimin e njohurive nga familjet me pyje private, projekt i mbështetur nga USAID dhe SNV.

Me këtë program "ERA" ka parashikuar implementimin e 6-8 iniciativave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Bjeshkët e Namuna. Këto iniciativa do të realizohen përmes skemës së grandeve të vogla. Programi trajnues ka përmbajtur dy trajnime në Pejë dhe një detyrë shtëpie gjatë kohës në mes dy trajnimeve. Trajnimi i parë zgjati tri ditë, ndërsa i dyti dy. Në trajnimin e parë treditor pjesëmarrësit patën rast të mësojnë për metoda interaktive, praktike, përmes këtyre pyetjeve:

- ❖ Në cilat iniciativa për zhvillim të qëndrueshëm njerëzit në Bjeshkët e Namuna janë duke punuar e menduar?

- ❖ Çfarë është qëndrueshmëria dhe si është zbatuar në një sërë vendesh rurale në Evropë?

- ❖ Si një jetesë e qëndrueshme në një fshat alpin duket në realitet?

- ❖ Pse zhvillimi i qëndrueshëm është i rëndësishëm në Bjeshkët e Namuna?

- ❖ Ç'mund të bëni në fshatin tuaj që të krijoni bazat për zhvillim të qëndrueshëm praktik?

- ❖ Si mund të ndjeheni të fortë e të guximshëm për të folur për zhvillim të qëndrueshëm?

- ❖ Si mund të komunikoni në mënyrë efektive me grupe interesi, si partnerë potencialë për projekte, autoritetet lokale, sipërmarrësit?

- ❖ Ç'është një projekt i zhvillimit të qëndrueshëm dhe si zhvillohet një koncept projekti?

Në kuadër të projektit "Zhvillimi i Qëndrueshëm Alpin në rajonin e Bjeshkëve të Namuna" është synim mbështetje e një numri iniciativash për zhvillim të qëndrueshëm alpin. E këto iniciativa duhet të ndjekin disa karakteristika:

- ❖ Të zbatohet në Bjeshkët e Namuna dhe/ose plotësisht të përqendrohet në zgjidhjen e problemeve mjedisore ose ngritjen e statusit

në mbrojtjen e këtyre Bjeshkëve.

- ❖ Të ketë ndikim afatgjatë për Bjeshkët e Namuna, banorët dhe biodiversitetin.

- ❖ Të sigurojë rezultate konkrete, si:

- Rritja e mbrojtjes natyrore dhe biodiversitetit;

- Promovimi dhe praktikimi i jetesës së qëndrueshme

- Zhvillimi i qëndrueshëm i grave e sidomos i të rinjve.

Pas përfundimit të pjesës së parë të trajnimeve, përfaqësues të shoqatave pjesëmarrëse u shprehën shumë të kënaqur e të gatshëm të punojnë me konceptin e iniciativës për te cilën punuan e mësuar gjatë ditëve të trajnimit. Sipas Fatos Lajcit, përgjegjës pranë "ERA", pjesëmarrësit në trajnim do të kenë rastin që iniciativat e paraqitura t'i im-

plementojnë edhe në koordinim me OJQ të tjera, çka është mirëpritur nga të gjithë. Ky është edhe synimi ynë që shoqatat, shoqëria civile dhe individët, bashkërisht, të punojnë për përmirësimin e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Bjeshkëve të Namuna.

Pjesa e dytë e trajnimeve, apo punëtorja e dytë, u përqendrua në zhvillimin e projektit, hartimin e propozimit dhe keshilla rreth implementimit të projektit, duke përfshirë fazat e projektit, afatet kohore, planifikimin e buxhetit, komunikimin me donatorët, etj.

Pas këtij trajnimi, shoqatat pjesëmarrëse do të përgatisin projekt-identet për të cilat kanë punuar gjatë trajnimeve, si dhe do të kenë rast të aplikojnë në fillim të prillit të këtij viti.



## Shënime nga rrethi i Matit

Gjon FIERZA

Shef i seksionit të Ekstensionit, DSHP, Tiranë

# Një ditë në pyjet komunale të Suçit



**P**ynet si ekosistem kryesor në përmirësimin e klimës, në parandalim të ndikimeve negative të ngrohjes globale, marrin rëndësi të veçantë, rol që kërkon vlerësim maksimal nga qeveritë dhe shtetasit e çdo vendi. Po ashtu, produktet pyjore, drusore e jodrusore, janë burim i rritjes ekonomike. Sipas raporteve të Bankës Botërore, vlera globale e këtyre produkteve në treg arrin rreth 270 miliardë dollarë në vit.

Vlerësimi për pyjet, pothuaj në çdo vend të botës dhe prirja për decentralizim, duke u kaluar të drejta pronësie e përdorimi komuniteteve vendore, vjen nga rëndësia që kanë pyjet për prodhimet drusore e jodrusore që japin, të cilat janë jetike për mjaft zona, për ndikimet mbrojtëse e shoqërore, që çmohen në vlerë 3-20 herë më të madhe se vlera e prodhimeve drusore vjetore; si sisteme bioenergjetike, ekosistemet pyjore paraqesin "uzina" të vërteta prodhuese energjie. Dhe, së fundi, nëse lënda drusore mund të silltet nga vende

të tjera, pyjet nuk mund të importohen; ato duhen ruajtur ose krijuar në çdo vend dhe duhen qeverisur për kryerjen e funksioneve të shumëllojshme të tyre.

Një nga reformat kryesore në pylltarinë shqiptare pas viteve '90, ka qenë kalimi i pyjeve dhe kullotave në pronësi/përdorim të komunave e bashkive. Kjo ka zënë vend në programet dhe është mbështetur nga të gjitha qeveritë dhe disa donatorëve ndërkombëtarë. Ky proces ka synuar përfshirjen e fshatarësisë në vendimmarrje për pyllin, si partner logjik për ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve, për rritjen e shërbimeve të tij në përmirësim të jetës në zonat rurale. Është synuar që çdo fshat e familje t'i kthehet traditës, të njohë territorin e tij jetik dhe të kontribuojë në ruajtjen e tij. Procesi i transferimit të pyjeve e kullotave ka kaluar në disa faza, shoqëruar edhe me investime e propagandë për të ndaluar degradimin nga prerja e kullotja, diku për të mos shkukur nga rrënjët atë fond pyjor që ka mbetur. Ka pasur rezultate të mira atje ku janë mbështetur në traditat e fshatrave, ku ka pasur bashkëpunim të mirë përdorues tradicional - pushtet vendor -

shërbim pyjor, mbështetur dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Popullsia dhe qeverisjet vendore në rrethin e Matit, janë ndër të parat që janë përfshirë dhe kanë mbështetur procesin e qeverisjes së pyjeve nga popullatat vendore. Mbështetja nga dy projekte të pyjeve, financuar kryesisht nga Banka Botërore, që janë zbatuar nga vitet 1996 - 2011, ka dhënë rezultate të mira e të matshme. Mjafton të kalosh nga gryka e Shkopetit deri në Klos, të shohësh si janë ripërtëritë dhe si po zhvillohen dushkajat në luginën e Matit. Janë komunat, Ulzë, Baz, Suç, Kurdari, Klos, etj., ku vetë komunitetet vendore, përdoruesit tradicionalë, pushteti komunal, kanë ndaluar prerjet abuzive. Ata vetë, me mundësitë që kanë, po u shërbejnë pyjeve dhe, si shpërblim për plotësim të nevojave të veta, marrin dru zjarri, ushqim për blegtorinë, etj. Tashmë në grumbujt pyjorë në brigjet e liqenit të Ulzës çdo vit numri i pushuesve dhe vizitorëve po rritet. Lugina e Matit për një periudhë të shkurtër duket se do jetë një ndër vendpushimet e pëlqyera për vendasit dhe të huajtë. Peizazhi që po krijon pyjet e përtëritë dhe pasqyrat ujore, që ndërthuren bukur me relievin kodrinor e malor të luginës, i japin vlera ekoturistike kësaj zone, e afërt me qendra të mëdha urbane nga Shkodra deri në Tiranë.

Janë vetë banorët vendorë, mbështetur dhe nga shërbimi pyjor i Matit, që kanë filluar t'i vlerësojnë pyjet dhe pamundësinë e jetesës në mungesë të tyre. Në mesmars 2012, ndoshta si përmbyllje të fushatës së pyjeve për sezonin 2011-2012, në komunën Suç u realizua mbjellja e rreth 200 kg lende lisi. Kjo veprimtari, e organizuar nga shoqata e pyjeve dhe drejtuesit e komunës Suç dhe e mbështetur nga shërbimi i Ekstensionit të DSHP Mat, realizoi mbjelljen e disa çeltirave në dushkajat ekzistuese, prej rreth 2 ha. Nd-ryshe nga praktikën e ndjekura deri tani për përmirësim dhe ripërtëritje të dushkajave me ricungime, u përdorën lendet e dushkut. Synimi është që në të ardhmen të ketë pyje me origjinë farore, të ketë përsëri dushkaja trungishte dhe jo vetëm cungishte, siç janë sot.

Shefi i seksionit të Ekstensionit të DSHP, Mat, Genti Çupi, vlerëson jo vetëm risitë teknike të këtij pyllëzimi, por edhe punën dhe pjesëmarrjen e gjerë në këtë proces, jo vetëm të drejtuesve të komunës e shoqatës, por të disa fermerëve përdorues të pyjeve. Ata, vullnetarisht që në vjeshtë, i mblodhën e ruajtën lendet e dushkut. Ne e organizuam mbjelljen, shton inxh. Genti, me pjesëmarrje të gjerë edhe nga komunat e tjera të Matit. Synojmë që në sezonin

e pyllëzimeve që vjen, ky proces ripërtëritjeje i dushkajave me farë të shtrihet sa më gjerë.

Pas mbjelljes së lendeve të dushkut, kërkohet përkujdesje tjetër, ndoshta pune më e madhe se mbjellja. Që të rriten bimëzat e sapombira, kërkohet së pari një mbrojtje e zonës së mbjellë, pra të mos ketë kullotje. Janë vetë banorët vendas që e kanë marrë përsipër këtë. Të kryhen disa shërbime kulturore, për rritjen sa më të mirë të fidanëve. Kjo u mor përsipër nga fermeri Xhemal Skura dhe shoqata e pyjeve, e drejtuar nga Mazllëm Çeliku.

Kryetari i komunës, Lutfi Cara, në përmbjellje të kësaj veprimtarie shprehu kënaqësinë që banorët e komunës Suç tashmë janë ndërgjegjësuar jo vetëm për t'i mbrojtur pyjet, po edhe për t'u shërbyer atyre. Ai tha se komuna do të mbështesë shoqatën e pyjeve dhe fermerët të vecantë, investimet në pyjet do të zënë vend të rëndësishëm në buxhetin e komunës. Ne tashmë e kemi të qartë se çdo lek që investojmë tani në pyje, brenda një kohe të shkurtër do të disa-fishohet.

Mbjellja e lendeve të dushkut në pyjet komunale të Suçit është një veprimtari që mund të përgjithësohet edhe në komunat e tjera të vendit. Dushkajat janë grumbujt pyjorë komunalë me të cilët është e lidhur më ngushtë jeta e banorëve në mjaft fshatra.



# Vendimmarrja për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve

Vijon nga fq. 1

prodhuar efekte me vlera për shoqërinë.

Për të gjitha analizat sektoriale, dokumentet më të plota, me të dhëna të rëndësishme për pyjet, deri tani janë Inventari Kombëtar i Pyjeve (2003) dhe Planet afatgjata të menaxhimit, të cilat janë në proces hartimi.

Me të drejtë thuhet se nga të gjitha fazat e vendimmarrjes, ajo e përgatitjes është më e rëndësishmja dhe prej saj varet cilësia e vendimmarrjes. Vetë akti përfundimtar është me efekte që mund të jenë pozitive apo negative, varësisht nga aftësitë e vendimmarrësve.

Planifikimi në pylltari bëhet në disa nivele. Nivelet bazë përfaqësojnë planifikimin strategjik, taktik dhe operativ. Për nivelin strategjik hartohen plane për periudhë më të gjatë kohe, madje deri në 100 vjet dhe për sipërfaqe më të mëdha. Për arsye praktike, këto llogaritje nuk janë të detajuara. Planifikimi taktik zakonisht përfshin një periudhë prej 5-20 vjet. Në këtë planifikim, planet e menaxhimit janë të specifikuar, me aktivitete e orar zbatimi dhe me rezultatet që priten. Planifikimi tradicional i pronarëve privatë në zonat rurale, zakonisht ka përfshirë një periudhë 20 vjeçare, me prerje në shirita të pyllit, nga poshtë deri në majë të malit. Planifikimi operativ i specifikon në detaje aktivitetet deri te paketat e punëve, me kohën dhe pjesëmarrësit në zbatimin e tyre.

Aktivitetet në pylltari japin efekte afatgjata, si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ajo mjedisore e sociale, por edhe gabimet e mundshme, japin pasoja afatgjata, sidomos në zonat me rëndësi ekologjike. Menaxhimi i këtyre aktiviteteve kërkon aftësi të mëdha. Këto aftësi në radhë të parë kanë të bëjnë me vlerësimin dhe analizën e informacionit të krijuar nga procesi i punëve.

Procesi i vendimmarrjes që ofron siguri më të lartë arrihet me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit. Në këtë rast, do të jetë shumë më e lehtë ndarja e përgjegjësi në zbatimin e këtyre vendimeve. Ky participim është vullnetar, ku pjesëmarrësit këmbëjnë informata, shprehin mendimet e tyre dhe artikulojnë interesat e tyre.

Objektivat e qarta janë pika referimi, për aktivitetet të cilat mund të sigurojnë asistencë më të lehtë për zbatimin e tyre.

Formulimi i objektivave gjatë planifikimit të politikave për zhvillimin e pylltarisë në Kosovë është zvarritur për gati një dekadë, pavarësisht faktit se që nga paslufta, shumë organizata ndërkombëtare kanë mbështetur këtë sektor dhe kanë dhënë udhëzime. Formulimi i tyre për një kohë të gjatë i është nënshtruar "lojës" politike dhe formaliteteve juridike të rezolutave ndërkombëtare. Edhe programet politike të synuesve vendorë për pushtet, politikat e tyre për sektorin e pylltarisë, i kanë improvizuar, duke i prekur ato përmasa që kanë lënë përshtypje elektorale. Në anën tjetër, institucionet tona, për shkak të

debatit të stërzgatur në mes aktorëve vendorë e ndërkombëtarë, nuk kanë arritur për një kohë të gjatë të marrin vendime cilësore. Këto vendime zakonisht janë parë në dritën e rëndësisë së statusit të vendit dhe kanë qenë të motivuara politikisht. Prandaj edhe vendimet kanë qenë jetëshkurtra dhe kompromiset ndërsektoriale janë zgjidhur me firmosjen e memorandumëve të bashkëpunimit, të cilat nuk kanë pasur fuqi detyruese. Kështu, aktivitetet nuk kanë qenë të bashkërenduara e të kontrolluara, pothuaj nga askush. Donatorët e interesuar, që kanë punuar në Kosovë, i kanë zgjedhur vetë fushat e mbështetjes dhe kanë realizuar projekte që shpesh nuk kanë qenë prioritet për zhvillimin e këtij sektori. Për shembull, në vitin 2002 u hartua Strategjia për zhvillimin e pyjeve (e cila nuk është miratuar), në vitin 2003 u miratua Ligji mbi pyjet dhe u bë Inventari i Pyjeve, ndërsa vetëm në vitin 2010 u hartua e miratua Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve 2010-2020 dhe u bë Decentralizimi dhe bartja e përgjegjësi për pyjet nëpër komuna. Këto aktivitete, sipas ekspertëve, më shumë janë improvizime të punës, sesa aktivitete të planifikuara për konsolidimin e këtij sektori. Nëse do të kishte pasur struktura të kualifikuara për marrjen e vendimeve, atëherë do të duhej që projektet të radhiteshin, duke u dhënë prioritet projekteve të Inventarit të Pyjeve, Strategjisë për Zhvillimin e Pyjeve e në fund do të duhej të hartohej ligji, i cili do t'i kishte objektivat krejt të qarta dhe do të ishte i zbatueshëm. Ky improvizim ka lënë pasoja të dukshme, jo vetëm në menaxhimin dhe zhvillimin e pyjeve, po edhe në dyfishimin e kostos për hartimin e dy strategjive, amendamentimit dy herë të ligjit mbi pyjet dhe, tani së fundi, hartimit të ligjit të ri dhe hartimit të dy palë planeve të menaxhimit për disa zona që janë shpallur zona të mbrojtura.

Vendimmarrja në sektorin e pylltarisë të Kosovës, po vazhdon të jetë e mjegulluar edhe për shkak të mungesës së një Këshilli Kombëtar për Pyjet. Themelimi i tij ka qenë obligim ligjor i saktësuar në Ligjin mbi Pyjet, i vitit 2003. Ky Institucion i lartë do të mund t'i shmangte pasojat e vendimmarrjes së gabuar dhe t'i adresonte më mirë problemet, duke i radhitur ato sipas përparësive. Në anën tjetër, edhe përzgjedhja dhe formulimi i objektivave të politikave pyjore, do të duhej të bazohej kryesisht në politikat e përgjithshme për zhvillimin e vendit. Por, Kosova ende nuk ka Strategji e Plan Zhvillimi të Vendit dhe zhvillimi i sektorëve të saj varet kryesisht nga disponimi dhe preferencat që kanë vendimmarrësit institucionale, të cilët dalin nga zgjedhjet elektorale, për akcilitet sektorë.

Politikat pyjore janë pasqyruar në "Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë" 2010-2020, të cilat synojnë mbështetjen e sektorit të pylltarisë, për të dhënë

kontribut në zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social të vendit. Por, edhe këtu nuk janë përfshirë nevojat e popullsisë për dru dhe reforma institucionale, pa të cilat kjo strategji ka mbetur uloke.

## Vendimmarrja në pylltari, bazuar në teknikat dhe metodat bashkëkohore

Njëzetë vitet e fundit, menaxhimi i përgjithshëm i pyjeve ka ndryshuar shumë. Pyjet tani po menaxhohen në atë mënyrë që prodhojnë të ardhura, duke e ruajtur mjedisin dhe interesat e komunitetit njëkohësisht. Vitet e fundit pyjet kanë marrë vlera të shumëfishta, nga të cilat edhe vlera të tilla, që nuk këmbehen në treg. Këto vlera të reja e kanë vështirësuar planifikimin dhe vendimmarrjen. Kjo situatë e ka bërë joefikase vendimmarrjen tradicionale intuitive, e cila i ka zgjidhur problemet komplekse, duke i thjeshtësuar ato dhe ka nxjerrë nevojën e gjetjes së modeleve të reja, që mund të zbatohen për menaxhimin shumëqëllimor të pyjeve. Në përgjithësi, vendimmarrja ka të bëjë me përzgjedhjen e një alternative për zgjidhjen e problemeve të tanishme. Me vendimmarrje synohet arritja e objektivave, nëpërmjet caktimit të kriterëve, me të cilat maten arritjet e këtyre objektivave. Pësha e kriterëve dhe alternativat reflektojnë rëndësinë e problemit që është shtruar për zgjidhje. Në procesin e vendimmarrjes, nga disa alternativa, vendimmarrësit e zgjidhin alternativën që e konsiderojnë si më të mirën. Për ta zgjedhur alternativën më të mirë, vendimmarrësit duhet ta bëjnë klasifikimin e tyre. Ky klasifikim mund të bëhet vetëm atëherë kur vendosen kriteret, të cilat duhet të jenë të besueshme dhe për vendimmarrësin janë me peshë, për zgjidhjen e problemit. Në renditjen e alternativave duhet të merren parasysh të gjitha kriteret.

Në pylltarinë tonë, në të kaluarën nuk janë përdorur metoda dhe teknika të reja për menaxhimin e aktiviteteve në pyje. Zhvillimi dhe zbatimi i tyre në të ardhmen mund të sigurojë një instrument të ri me vlerë, i cili do të ndihmojë nivelin strategjik, taktik dhe operativ të vendimmarrjes. Theksi duhet të vihet në nevojën që propozimi për vendim-

marrje të bazohet në argumente të arsyeshme.

Sipas ekspertëve, sektori i pylltarisë në Kosovë është shumë i ngadalshëm në aplikimin e metodave dhe teknologjive të reja. Ndërkaq, në vendet e zhvilluara, madje edhe përdorimi i numrave dhe optimizimi i alternativave, po konsiderohen si të pamjaftueshme dhe të pabesueshme, për planifikim dhe menaxhim. Pylltaria e sotme, me objektiva shumëqëllimore dhe me shumë palë të interesuara (shpesh me interesa të ndryshme), po kërkon fleksibilitet në vendimmarrje, për përfshirjen e sa më shumë intereseve.

Planifikimit dhe vendimmarrja në pyje është shumë komplekse, për shkak të objektivave të shumta të menaxhimit. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve, duhet ta marrë kontrollin e përdorimit të pyjeve dhe tokave pyjore, në atë mënyrë që të ruajnë biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësitë e ripërtëritjes, vitalitetin dhe potencialin, për t'i bërë të mundur pyjeve që tani dhe në të ardhmen t'i plotësojnë funksionet ekonomike, mjedisore e sociale.

Në veçanti, për mbështetjen e bizneseve, po kërkohen metoda dhe modele të reja, me të cilat do t'u mundësohet atyre parashikimi, planifikimi dhe analizimi më i mirë i operacioneve, për arritjen e rezultateve në pylltari. Kurse në vendin tonë (e madje edhe në tërë Ballkanin), ku druri vazhdon të përdoret si burim energjie, zbatimi i këtyre metodave, të cilat duhet të mbështeten edhe në traditën e pasur të shfrytëzimit të planifikuar, është nevojë e ngutshme.

Menaxhimi i planifikuar i pyjeve është bërë instrumenti më i rëndësishëm, i cili drejton administratën dhe shfrytëzuesit e tyre, drejt përfshirjes së gjerë të publikut në vendimmarrje. Synimi është i qartë, të mbështesë vendimmarrjen, për të arritur raporte të mira në mes pyllit e njeriut, me çka do të plotësohen njëkohësisht kriteret dhe kërkesat e parashtrua nga menaxhimi.

Për të përfshirë interesat e aktorëve të shumtë, në planifikimin dhe zhvillimin e pyjeve (e cila është edhe kërkesë e opinionit), kohët e fundit, siç përmendëm, po përdoren me të madhe

Metodat Shumëkriterëshe të Vendimmarrjes (MSHV) – *Multiple Criteria Decision Making (MCDM)*. Ndër këto metoda, që kanë gjetur përdorim të gjerë në pylltari, përmendim: Analiza e të Dhënave mbi Mbulesën – *Data Envelopment Analysis (DEA)*, Analiza Hierarkike e Procesit – *Analytic Hierarchy Process (AHP)*, Teknika e Thjeshtë Shumëkriterëshe e Vlerësimit – *Simple Multi-attribute Rating Technique (SMART)*, Metodat e Klasifikimit – *Outranking Methods*, Metodat e Votimi, etj.

Këto metoda janë zhvilluar për t'u ndihmuar situatave komplekse dhe zbatohen kur është e nevojshme, që të shqyrtohen e vlerësohen alternativat e ndryshme për vendimmarrje, në veçanti kur ajo vështirësohet për shkak të kriterëve të shumta dhe konfliktit të interesave në mes të aktorëve të shumtë.

Në kushtet e Kosovës, ku kemi të bëjmë me grupe të strukturave të ndryshme të pyjeve si: (i) Pyjet e larta, me ripërtëritje farore natyrale; (ii) Pyjet e ulëta – cunqishte me ripërtëritje vegjetative; (iii) Pyjet shkurre. Në këtë rast edhe modelet e zgjedhura duhet ta orientojnë vendimmarrjen drejt objektivit për arritjen e rezultateve maksimale në menaxhim dhe zhvillimin e grupeve të strukturave të ndryshme pyjore.

Në kushtet tona, kushti i parë që duhet të përmbushet për t'i zbatuar këto metoda e teknika është pasja e një baze të besueshme të dhënash, pasi pikërisht këtu është pika më e dobët e pyjeve tona. Për shkak të presionit të madh në pyje, i cili nuk ka pasur intensitet të zvogëluar për shumë vite, ka shumë zëra të ekspertëve, që deklarojnë se raporti i inventarizimit është vjetruar dhe, si i tillë, nuk mund të shërbejë si burim i sigurt të dhënash gjatë vendimmarrjes.

Planet afatgjata të menaxhimit, të cilat janë në proces hartimi, janë burim i sigurt i të dhënave të besueshme, për përdorim e tyre në këto modele e teknika dhe rezultatet e tyre mund të merren parasysh nga vendimmarrësit, për zbatimin e tyre në pylltari. Megjithatë, zbatimi i metodave shumëkriterëshe, nuk mund t'i zhvendësojnë mjetet dhe procedurat tradicionale të planifikimit dhe menaxhimit të pyjeve, por ato mund t'i plotësojnë e pasurojnë.

## Ndahet nga jeta tekniku i pyjeve Hajdar Çerkezi

Para disa kohësh, pas një sëmundjeje të rëndë, ndërroi jetë tekniku i pyjeve Hajdar Çerkezi. Në rreth 35 vite të jetës, iu përkushtua profesionit të pylltarit, dashurisë për pyjet. Ai punoi në çdo skaj të Kukësit e Hasit, në pyjet e Arnit, të Bushtricës, të Fajzave, Helshanit, Golajve, etj. Të gjithë ata që kanë pasur rastin të punojnë me Hajdarin, kanë vënë re tek ai cilësitë e mira e burrërore, profesionale, njeriun e dashur, gazmor e korrekt. Hajdari e kishte zgjedhur vetë profesionin e pylltarit që në vogli, kur thoshte se ky është profesioni më i bukur. Ai i donte pyjet dhe natyrën, prandaj jetën e lidhi me këto pasuri që t'u shërbejnë brezave. Në shkollën e Mesme Pyjore në Shkodër, ai u dalluar si nxënës i mirë

në mësim, po edhe futbollist i shkathët e valltar i talentuar. Hajdar Çerkezi, si udhëheqës i grupit të valltarëve të shkollës, ka kërcyer vallet e Kukësit, po jo vetëm ato, në skenën e Teatrit "Migjeni", në atë të Klubit të Rinisë "Heronjtë e Vigut" dhe në shumë skena të tjera në ish-ndërmarrjet e qytetit të Shkodrës.

Hajdar Çerkezi u lind në Tregtan të Hasit me 23.06.1954. Në vitet 1971-1975 kreu Shkollën e Mesme Pyjore, Shkodër dhe u titullua teknik i mesëm pyjesh. Po në vitin 1975 emërohet teknik pyjesh në Arrën. Në vitet 1978-1980 punoi brigadier në fidanishten e NP Kukës dhe në vitet 1981-1983, teknik në zonën e Bushtricës. Nga viti 1983, deri sa ndërroi jetë (dhjetor 2011), ai punoi teknik e përgjegjës



sektori në zona të ndryshme pyjore të vendlindjes, në Has.

Me vdekjen e Hajdarit, familja humbi njeriun e shtrenjtë e të dashur, ne kolegun, që do mbetet gjatë në kujtesën tonë.

Janë këto pak rreshta, me të cilat duam t'u shprehim ngushëllime familjes dhe të afërmve, për vdekjen e parakohshme të Hajdarit. I paharruar kujtimi i tij, i lehtë dheu që mbulon trupin e tij.

**K. Malaj, M. Dida, Gj. Fierza, R. Peka, M. Ymeri, S. Peka, I. Tobli, I. Sefolli, I. Alia, R. Ndreu, Xh. Shutli, M. Geci ...**



# Dhuratë e veçantë për 8 Marsin ...

Për Federatën e Pyjeve, Shkodër  
Sokol GURI, Kryetar  
Eva STERKAJ, Koordinatore

... I tillë u konsiderua ky 8 Mars për rreth 90 gra nga komunat Shllak e Shkrel, të përzgjedhura komuna-pilot nga SNV, të cilat morën pjesë në një aktivitet të organizuar nga Federata e Pyjeve, Shkodër dhe financuar nga SNV. Aktiviteti u organizua në kuadër të projektit në proces, që SNV, në bashkëpunim me Federatën e Pyjeve, po zbaton për forcimin e kapaciteteve lokale 2. Një ndër objektivat kryesore është edhe arritja e qëllimit për përfshirjen e gruas në veprimtaritë e pylltarisë komunale, si dhe në vendimmarrje.



Gjate vitit 2011, në kuadër të projektit për forcimin e rolit të Gender janë realizuar në të gjitha fshatrat e dy komunave, Shllak e Shkrel, takime me gratë. Pra, në këto takime kanë marrë pjesë rreth 850 gra nga 21 fshatra. Në secilin fshat është bërë përzgjedhja e grave kyç, që do të bëhen pjesë e shoqatave të pyjeve e kullotave komunale. Mbi bazën e këtij objekti SNV në bashkëpunim me Federatën e Pyjeve Shkodër, organizoi këtë aktivitet me rastin e 8 Marsit. Ishin të pranishëm edhe përfaqësues të institucioneve nga Shkodra dhe Malësia e Madhe.

Në konferencën e organizuar në një nga sallat e teatrit Migjeni, u bënë tre referime:

Në referatin e përgatitur nga Eva Sterkaj flitej për rëndësinë që ka nxitja dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale, duke u bërë kështu pjesë domethënëse dhe e rëndësishme e shoqatave të përdoruesve të pyjeve komunale.

Në referatin e përgatitur nga Drejtorja e Shërbimit Pyjor, Shkodrës, u paraqit gjendja e pylltarisë komunale; rëndësia e menaxhimit të qëndrueshëm të pyllit komunal.

Tema e tretë dhe përmblylëse e konferencës ishte barazia gjinore, mundësia e përfshirjes së grave në jetën publike. Mundësitë dhe hapësirat që ofron legjislacioni shqiptar në këtë drejtim. Kjo temë u trajtua nga përfaqësuesja e zyrës së punës, Shkodër.

Shumë e veçantë ishte edhe vizita e planifikuar me të gjitha gratë pjesëmarrëse në një punishte prodhimesh artizanale në lagjen Zogaj, punishte e suksesshme e bashkëpunimit të disa grave.



Takimi i mbyll me një dreke festive në një nga restorantet tradicionale të Shkodrës, ku zhvilluan biseda, u këmbyen mendime e u bënë sugjerime, me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm e frytdhënës të pyjeve e kullotave komunale.

Nuk mund të lihen pa përmendur falënderimet dhe mirënjohja që këto gra shprehën për përfaqësuesit e SNV dhe ata të Federatës së Pyjeve. Kjo jo vetëm për mundësimin e festës, po edhe për ndihmën e konsulencën e ofruar prej tyre për menaxhim të qëndrueshëm e frytdhënës të pyjeve e kullotave komunale.

Për organizimin me sukses të kësaj veprimtarie, falënderime shkuan edhe për z. Mark Rupa, si dhe për kryetarët e komunave, z. Hilë Kodra e Ferdi Sterkaj, për mbështetjen, seriozitetin dhe përkushtimin e treguar.



## 8 Marsi nuk lindi si festë!

A. ZEBI

SNV, në bashkëpunim me organizatën Agritra - Vizion dhe Federatën e Pyjeve Komunalë, Dibër, mbështetur nga Sida dhe Kvinna till Kvinna, organizuan një takim kushtuar Ditës Ndërkombëtare të Grave. Takimi u organizua me datën 9 mars, me qëllim për të parë se çfarë ndodh me gratë një ditë pas festës ku mendohet se atyre u falet më shumë dashuri e mirënjohje. Por ... "U kthehem përsëri halleve tona, ngarkesës nga punët e shumta dhe streseve, që na shkakton papunësi, mentaliteti ...". Kështu u shpreh një nga pjesëmarrëset në takim ...

Takimi filloi me një prezantim mbi rolin e rëndësishëm që luan gruaja në familje e shoqëri dhe vazhdoi me historikun e 8 Marsit. Nga këto prezantime morën fillësë edhe diskutimet e të pranishmeve, gra aktive nga komunat e Dibrës, përfaqësues nga Qarku, nga Zyra e punës e Shërbimi social, nga Federata e Pyjeve Komunalë dhe MADA. Diskutimet synuan ndarjen e informacionit dhe shkëmbimin e ideve për të përmirësuar situatën ku ndodhen gratë rurale të Dibrës. Të dhënat lidhur me numrin e grave të papuna dhe ato për gratë pjesëtare të strukturave vendimmarrëse, mbeten akoma shumë shqetësuese. Po ashtu, edhe numri i grave sipërmarrëse është shumë i ulët. Aksesi në treg është i kufizuar dhe pak gra përfitojnë nga shërbimet mbi marketingun.



Përfaqësuesi i Qarkut, Zejnullah Mehmeti, u zotua se barazia gjinore do të zërë një vend të veçantë e më të detajuar në Strategjinë e re Rajonale të Zhvillimit. Përfaqësuesi i MADA-s, Jonuz Paci informoi të pranishmit mbi mundësitë që ky fondacion krijon për sipërmarrjet e grave. Një nga gratë sipërmarrëse, që ka përfituar nga kjo mbështetje, ndau përvojën e saj me të pranishmit. Kryetari i Federatës së Pyjeve e Kullotave Komunale Zenel Shehi beri një përmbledhje të aktiviteteve që Federata ka ndërmarrë me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave në strukturat vendimmarrëse në pyje. "Pavarësisht se sektori i pyjeve konceptohet si sektor që dominohet nga burrat, ne kemi bërë përpjekje që të përfshihen edhe shumë gra e vajza eksperte në pyje, në strukturat tona, nënvizoi ai. Dhe sot koordinatoresha jonë është një vajzë inxhinierë dhe në nivel kombëtar janë disa shembuj të tillë", u shpreh z. Shehi.

SNV njoftoi të pranishmit për finalizimin e dokumentit të Strategjisë së Çështjeve Gjinore, misioni i së cilës është: "Të sigurojë që burrat e gratë të kenë mundësi të kontribuojnë e përfitojnë në mënyrë të barabartë nga përdorimi i burimeve dhe vendimmarrja në pyje". Kjo strategji e hartuar në kuadër të Projektit Forcimi i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, synon të ndërhyjë për fuqizimin ekonomik dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në strukturat vendimmarrëse në pyje.

Në fund të takimit pjesëmarrësve ju dhurua nga një tufe mimosa meqë kjo lule për shumë vende është simbol i Ditës Ndërkombëtare të Grave.

## Gruaja rurale dhe pylli

Anila ALIAJ, SNV - Kukës

Nisur nga tema e këtij viti për Ditën Ndërkombëtare të Grave, "Fuqizimi i Grave Rurale – T'i jepet fund varfërisë dhe urisë", vëmendja drejtohet te gratë dhe burimet që ato të punojnë e jetojnë, si në bujqësi, blegtori, pyje, etj. Kur mendon për gratë që banojnë në zonat rurale e sidomos kur analizon temën ndërkombëtare të fuqizimit të këtyre grave, menjëherë lindin disa pyetje: Si është gjendja e këtyre grave, sa "të fuqishme" janë ato aktualisht? Si mund të fuqizohen ato? Kush mund ta ndërmarrë një iniciativë të tillë? Ç'politik apo mjete lypsen për të bërë një gjë të tillë? ...



SNV, tashmë organizatë mjaft e njohur në vendin tonë, gjatë implementimit të aktiviteteve të saj dhe në mbështetje të Federatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, është kujdesur që të rrisë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e gruas në sektorin pyjor. Tradicionalisht ky sektor ka qenë dominuar nga meshkujt, por ndërsa kjo është e vërtetë për procesin e vendimmarrjes, studimet tregojnë se gratë janë po aq të përfshira dhe kontribuojnë në të. Gratë mbledhin bimë mjekësore e dru zjarri, kullosin bagëtitë, bëjnë edhe pastrime të pyllit, por ato nuk marrin vendime për këto prona të mbartura tradicionalisht. Në kuadër të projektit "Fuqizimi i Qëndrueshëm i Pyjeve Komunal II në Shqipëri", financuar nga Sida e implementuar nga SNV, janë ndërmarrë disa aktivitete, me qëllim përmirësimin e jetës dhe fuqizimin e grave që banojnë në zonat rurale. Më konkretisht: në qarkun e Kukësit po punohet në dy komuna-pilot, në Malzi të Kukësit dhe në Bujan të Tropojës. Fuqizimi i grave në këto zona është parë në tre aspekte kryesore:

1. Përfshirja e grave në vendimmarrje në shoqatat e pyjeve dhe kullotave komunale, që operojnë në këto komuna-pilot e konkretisht në fshatrat e përzgjedhur, Petkaj dhe Gri.

2. Ngritja e kapaciteteve të grupeve të grave.

3. Fuqizimi ekonomik i grave të organizuara në grupe prodhuese.

Por, megjithëse vihet re rritje e lehtë e pjesëmarrjes së grave në takime, seminare e trajnime, duhet thënë se raporti i grave që marrin pjesë aktivisht në aktivitete praktike në pyje. Shpesh gratë nuk tregojnë interes t'i ndjekin këto takime, por edhe nga fakti se janë shumë të zëna me punë shtëpie, me rritjen e fëmijëve e kujdesin për të moshuarit, me punët bujqësore, etj., saqë mendojnë se burrat si me më shumë kohë të lirë, mund t'i ndjekin këto takime. Duhet thënë se edhe mentaliteti është paragjykes për

Vijon në fq. 7





Vijon nga fq. 3

## Pylli i fermerit ka zot fermerin

policia ambientale që të zbatojë me rreptësi ligjin. Le të hapet konkurrenca midis tri formave të pronësisë dhe pyjet do të shkojnë drejt menaxhuesit më të mirë. Kapitalizmi ka ligjet e veta. Kush e menaxhon keq pronën e humbet atë, koha do të tregojë kush ka të drejtë. Deri sot fermeri privat është i vetmi përdorues korrekt i pyjeve e i territorit dhe në një farë mase është bërë pengesë për mosshkatërrimin total të tyre.

**S. Karadumi:** Në Shqipëri, si në të gjitha vendet e okupuara nga otomanët, ka qenë sistemi i pronësisë së Timarëve, nuk ka pasur pyje e kullota private e komunale, ato kanë qenë pronë e Sulltanit, të cilat ua jepte e ua merrte atyre që i shërbenin mirë ose keq, kështu dhe përvoja për qeverisjen e tyre është shumë e pakët, ndryshe nga vendet evropiane. Me Vezirin kam qenë në një klasë, kurse Thimaqi është shumë më i ri. Bëni studimin tuaj dhe, nëse ata pak të vjetrit, i quani të rregullt, diskutoni dhe i miratoni, gjithnjë ai që ka pushtetin vendos. Uroj që pyjet të zhvillohen sa më mirë.

**Xhelal Shuti:** Për t' shërbyer këtij diskutimi, unë kam disa përvoja. Psh, në komunën Malzi të Kukës, po behet identifikimi i përdoruesve tradicionalë (pronarëve) dhe del se në 60 % të territorit fermerët kanë kufij të vendosur dhe respektohet tradita e përdorimit të pyllit nga të gjithë banorët e fshatit. Në fshat nuk ka asnjë prerje të paligjshme dhe asnjë rënie zjarri. Të gjithë janë të interesuar të fitojnë nga menaxhimi i pyllit. Kjo tregon se aty njihet prona private dhe është shumë më lehtë të zhvillosh procesin e të japësh këshilla teknike nga specialistët e pyjeve dhe sociale për mirëqeverisjen e zonave rurale.

**R. Ndreu:** Të falënderoj Xhelal, sepse shumë njerëz kuptojnë se dikush flet për interes personal apo për përfitime të çastit, ndërsa ne kemi një mision shumë të qartë, jo për interesa çasti po vetëm për të zhvilluar reforma, për të zhvilluar pyjet dhe të varfrit, që jetojnë e punojnë në trojet e tyre dhe duan të jetojnë atje, me pak tokë e pak pyll e kullotë, të jenë zot në trojet e tyre, siç ua kanë lënë të parët ...

**Jakov Bodurri:** Analiza duhet e plotë dhe e thellë, siç përmendet më lart, në vështrimin historik e gjeografik. Të mos bëhen veprime për hir të reformave, siç u bë me ndarjen e tokës. Po që se do mbetemi vetëm të kalimi në komuna, mendoj se nuk kemi bërë asgjë, bilë ka shumë raste deri tani, sidomos në jug dhe në Shqipërinë e mesme, që komunarët janë sehirxhij ndaj kësaj pronë. E them këtë, pasi në realitet në këtë rajon, në shumë territore nuk ka asnjë pronësi dhe njerëzit në një ditë të bukur pretendojnë të gjithë e kështu pëshqillohen e rriten edhe problemet sociale. Pra, shkurt, doja të shtoja se kjo reformë duhet të jetë e kujdesshme dhe të shoqërohet

me një kuadër ligjor, që të mos lejojë hapësira për keqmenaxhim dhe t'i paraprijë çdo veprimi ...

**Ramiz Metaliaj:** Kovi, që është analizë e thellë, nuk diskutohet. Kjo duket nga autorët.

**J. Bodurri:** Po, mos e luaj më, këtë, siç thuhet, se luan as topi.

**R. Metaliaj:** Shyqyr që kemi kuadro kaq të aftë, që e çojnë kaq thellë analizën.

**J. Bodurri:** Demokracia ka hapësira për të gjithë ...

**R. Metaliaj:** Dmth, sado thellë ta çosh analizën, lejohet në demokraci, ë? Këtë doje të thoshe?

**J. Bodurri:** Po, sa me thellë aq më mirë, se nga thellësia askush nuk është ankuar.

**R. Metaliaj:** E saktë, kjo i vë kapak ...

**S. Karadumi:** Cili është pronari? Sulltani!? Atëherë, kujt do t'i jepen pyjet? Mendoj se kjo duhet përcaktuar shumë drejt, ndryshe problemet e pronës shkaktojnë pasoja të paparashikuara. Ndoshta pjesërisht kjo mund të jetë e zgjidhur dhe e lehtë, por për të gjithë vendin duhet të këtë veçoritë e veta. Z. Rexhep, edhe sikur ta kishit realizuar vetë studimin, koha sjell probleme të reja e, për rrjedhojë, do ta ribënit. Janë bërë disa strategji të zhvillimit të pyjeve, pa u tharë boja e njërës është bërë tjetra, po ashtu planet e mbarështimit të pyjeve, hartat e pyjeve, etj. Bëjeni shumë mirë këtë studim dhe vendosni mbi baza më të drejta pronësinë mbi pyjet. Mbi një studim të saktë zgjidhni problemet e pronësisë dhe të zhvillimit të pyjeve. Ju uroj suksese ...

**P. Çoku:** Miqtë e mi, Jakov e Ramiz, një shprehje popullore thotë: sa të mendohet i mençuri budallai ka mbaruar punë. Nëse duam të shpëtojmë atë pak që ka mbetur nga pyjet, duhet të veprohet shpejt dhe në drejtimin e duhur.

**S. Karadumi:** Z. Rexhep, bëjeni këtë punë, pasi po u jepet rasti për të bërë diçka më afër shumë të mirës. Ngjarjet e kaluara i njoh mirë, çdo punë me kohën ka vend të bëhet më mirë.

**Xh. Meta:** Unë jam po me mendimin e Prof. Spiros. Nëse ky kalim do të bëhet me aksion, në prag fushatash zgjedhore, më duket se s'kemi arritur asgjë, po kemi nxitur një sherr social, i cili do t'u shërbejë të tjerëve dhe jo fermerit. Ndërsa për rritjen mesatare vjetore që kanë bërë në pyjet e fermerit, o zot ishalla nuk lexohet tamam, po merret për barcaletë, sepse që të analizohet rritja duhet të merren parasysh disa faktorë, prandaj ata që mbrojnë këtë tezë le të na i shpjegojnë me qartë e me argumente, sepse ky grup përbëhet nga inxhinierë dhe besoj se e kuptojnë nocionin rritje. Ndërsa studimet apo mbështetjet, etj., etj., të kësaj natyre deri sot kanë pasur karakter social, po nuk ka asgjë shkencore, nëse u referoheni planeve të mbarështimit komunal, ato kanë vetëm ngjyra të bukura, po shkencë jo.

**R. Ndreu:** Federatat e Korçës, Kukësit dhe Dibër, kanë shtatë vjet që bëjnë analizat dhe

marrin sipërfaqe prove për pyjet e fermerëve dhe të gjitha të dhënat i kanë të karakterit teknik. Kjo analizë ka kryesisht qëllim të mësojë dhe fermerin sa është rritja dhe si do të menaxhojë pyllin e vet, ... cili është qëllimi i pyllit, strategjia dhe aktivitetet në pyll ... por këtë do ta mësojnë njerëzit avash-avash; kjo bëhet me mbështetjen e ekspertëve më të mirë dhe me ndihmën e SNV-së ... SIDA 2, etj.

**Xh. Meta:** Z. Rexhep, njëherë na flet në emër të qeverisë dhe një herë në emër të kryetarit të shoqatave. Të kuptohemi, pyjet nëpër botë nuk janë ndërtuar me shoqata, por lindën si nevojë për të balancuar punën e qeverive ... Ne i ngremë problemet si specialistë. Mendoj se ju në rolin që keni nëse ju interesojnë mendimet tona merrini, nëse jo, mos i merrni. Ndërsa për t'na mbushur mendjen se si llogariten këto parametra, e para ne i kemi mësuar dhe e dyta, ka sa të duash literaturë. Por specialistë të fushës, që do të merren me këtë punë e shprehin qartë se është një proces i mundimshëm. Nëse do të bazoheni te planet e mbarështimit të pyjeve komunalë të mbështetur nga ..., e keni pikënisjen e gabuar. Problemi është gjetiu, se për këto punë që duhet t'i bëjnë njerëzit, dikush paguan dhe ai që paguan është populli (taksapaguesi i rregullt) dhe të behet diçka me "o burra" nuk është mirë. Le të marrë kohën e nevojshme, por të jetë i saktë, sepse ky popull boll ka paguar dhe shumë ka vuajtur e, nuk i intereson koha e humbur dhe konfliktet e reja, që do të lindin. Kur shkruajmë, përdorim fakte dhe jo për të kaluar radhën. Nuk kemi donatorë, që na mbështesin, por forcën, vullnetin për punë. Atë sistem atje e provuam dhe e dimë se si funksionon në gjithë vertikaltetin e tij.

**S. Karadumi:** Nuk do të dëshiroja të analizoj ato shifra këtu, por mund të përmend se sipërfaqja pyjore e vendit, sipas inventarizimit të fundit, rezultoi e zmadhuar, kur pyllëzime bëheshin shumë pak ose aspak. Fondi i prodhimit, nga rreth 83 milionë m<sup>3</sup> zbriti në rreth 60 milionë m<sup>3</sup>. Nëse u ricunguan dushkajat, komunale, private apo shtetërore, në moshat shumë të reja ato mund të japin shifrat që thoni ju, cungjet mund të rritin lastarë në moshë të reja, pastaj kjo rritje pakësohet shumë, deri në moshën e shfrytëzimit të cungishtës rreth 35-40 vjet. Nga këto pyje mund të prodhohet në moshat 35-40 vjeçare vetëm lëndë e holle nëse lisave nuk do t'u thahen majat, gjë që ndodh sidomos nga trajtimi i cungishtës për 2-3 turne. Bëmë punime me kosto dhe për 35-45 vjet morëm lëndë të holle, nën 20 cm diametër, në lartësinë e gjoksit. Po pastaj, nuk kemi asnjë program për të ardhmen e dushkajave, të cilat përbejnë rreth 1/3 e sipërfaqes së pyjeve të vendit.

**R. Ndreu:** I dashur Xhelil, singërisht mendoj se jeni keqkuptuar ... Unë ju sqarova ç'bëjmë ne, ose më mirë, Federatat Rajonale. Nëse ju se besoni, është puna juaj! Unë nuk bëra leksion, po thashë ç'kanë bërë njerëzit e ju i quani "barsoleta"! Unë nuk di të kem folur diku në



emër të qeverisë dhe ka 13 vjet që unë jam në rrugë të madhe, duke hequr dorë vullnetarisht dhe tani jam duke punuar në sektorin e shoqërisë civile ... Por, di se Austria, Suedia, Zvicra, Holanda, të paktën ku jam trajnuar unë, mbi 60 % e pyjeve (në total) janë pronë e privatëve të organizuar në Shoqata e Federata; madje Federata e Holandës ka në pronësi rreth 150 000 ha, që u bën menaxhimin, mbrojtjen, pyllëzimin dhe tregun, etj. Ne pretendojmë të ndajmë rolet dhe për këtë të gjithë biem dakord.

Prof. Spiron e falënderoj që vazhdoi komentimin. Mesa kam dëgjuar e parë, ata fshatarë që janë pronarë, një pjesë të cungishtave nuk kanë ndërmend t'i shfrytëzojnë në moshën e shfrytëzimit, pasi minierat janë mbyllur, por pjesën më të madhe do ta përdorin çdo 2-4 vjet, duke rralluar e prodhuar dru, gjeth, hunj e thupra dhe një pjesë do të fillojnë t'i trajtojnë për lëndë. Pastaj do të fillojë prodhimi pa pushim, sepse toka e bekuar na e jep këtë prodhim çdo vit, po ne duhet të jemi këshillues të mirë.

Unë ju falënderoj shumë të dashur miq të vazhdojmë debatin, të ndihmojmë njëri-tjetrin, pa komplekse dhe me shumë dashamirësi ...

**R. Metaliaj:** Unë mendoj se pyjet janë të atyre që i kanë pasur dhe, në mos sot nesër, do ti marrin. Mua me shqetëson zgjatja në kohë, duke nxitur përfitimet e padrejta nga pyjet e në emër të pyjeve. Kjo punë nuk kryhet me seminare e konferenca, po thjeshtë, me një VKM.

**R. Ndreu:** Të falënderoj z. Metaliaj. Shqetësimi juaj është i drejtë, koha ecën dhe singërisht shqetësimi i përdoruesve tradicionalë është që pyjet t'i kenë në pronësi dhe të regjistruhen në ZRRPP. Me VKM nr. 22, ka të drejtë këshilli i komunës t'i japë në përdorim, gjë që është refuzuar. Tani është pranuar nga të gjithë që ligji duhet ndryshuar, kur kanë ndryshuar pronat dhe pronarët. Në fakt, është bërë tenderi për ligjin, po pritet investimi nga SIDA dhe ligji do të ndryshojë, sepse nuk qeverisen pyjet nga Tirana, çdo pronar i ri duhet të këtë rolin e vet, Ministria rolin e politikave e strategjive dhe shoqatat rolin e menaxhimit e të sensibilizimit. DSHP, krahas menaxhimit të pyjeve të veta, do të ketë dhe strukturat këshillimore për komunat, shoqatat dhe privatët. Struktura të tjera të pavarura të kontrollojnë zbatimin e ligjit. Të paktën kështu është perceptimi ynë në strategjinë e ndërtuar ...

Vijon nga fq. 6

## Gruaja rurale dhe pylli

gratë e zonave rurale, ndonëse ato nuk paragjykojnë të bëjnë të gjithë punët që u dalin përpara, takimet duken luks e si të tilla, gratë e këtyre anëve nuk duhet ta kenë.

Prandaj, janë krijuar grupe me gra në të dy komunat-pilot, që të rritet ndërgjegjësimi me një grup e më pas të merret si model e të përhapet në gra të tjera. Kështu, duke përbushur objektivin e parë për përfshirjen e grave në vendimmarrje në bordet e shoqatave të pyjeve është arritur që në këto borde

të ketë 30 - 40 % femra, nga asnjë para se të fillonte projekti.

Sa i takon ngritjes së kapaciteteve të grave që banojnë në zonat rurale vazhdimisht janë përgatitur trajnime për grupet e grave të ngritura në komunat-pilot. Fillimisht gratë janë angazhuar në grumbullimin e të dhënave përmes pyetësorëve për përfshirjen e grave në aktivitetet pyjore, si dhe kontributin e tyre në gjenerimin e të ardhurave nga mbledhja e bimëve mjekësore, frutave të pyllit, etj. Gjate vitit 2012 do të implementohet një paketë e plotë me trajnime, që synon të japë më shumë njohuri për aspektet organizative, ekonomike e tregtuese, etj., ku mund të veçojmë:

- Trajnim mbi çështjet gjinore;
- Trajnim mbi ligjet dhe konventat për të drejtat e grave;
- Trajnim mbi avokatinë dhe lotimin;
- Trajnim mbi menaxhimin financiar;
- Trajnim për Planin e Biznesit;
- Trajnim mbi standardet për vjeljen, ruajtjen, tregtimin, etj., e bimëve mjekësore dhe arroveve.

Fuqizimi ekonomik është proces i vështirë, pasi të fuqizosh dikë ekonomikisht do të thotë t'i krijosh mundësi që të fitojë të ardhura të qëndrueshme. Pavarësisht kësaj, mendojmë se duke u dhënë mundësi grave të jenë pjesë e grupeve prodhuese – klubet e

arroveve – që janë krijuar në të dy komunat, është një mundësi për t'u përfshirë në zinxhirin e tregut (prodhues – konsumator). Synohet që këto klube të fuqizohen dhe të kenë mundësi të gjenerojnë të ardhura të qëndrueshme nga aktivitetet e tyre e, në këtë mënyrë, të arrihet fuqizimi ekonomik. Nga organizimi i takimeve mes grupeve prodhuese e tregtarëve, synohet t'u jepet mundësi grupeve prodhuese që të lidhin kontrata më të favorshme me tregtarët, si dhe të jenë më të informuar mbi mundësitë që ato kanë për gjenerim të ardhurash. Komponent shumë i rëndësishëm, i parashikuar në projekt, është edhe shkëmbimi i vizitave

rajonale, kombëtare e ndër-kombëtare, mes grupeve të grave. Këto vizita kanë për qëllim ndarjen e eksperiencave më të mira dhe mundësinë për të përshtatur modelet dhe praktikatat e rajoneve apo vendeve të ndryshme, me qëllim krijimin e të ardhurave të qëndrueshme nga produktet që kanë pyjet e rajonit të Kukësit.

Së fundi, ndonëse u dhamë përgjigje disa prej pyetjeve që parashtruan në fillim, mendojmë se mbetet akoma shumë për të bërë. Ne jemi përpjekur të japim disa modele, të cilat mund të përmirësohen e mund të përdoren nga vetë banorët, me synim integrimin e grave në këtë sektor, fuqizimin e tyre ekonomik, etj.



## The farmer is the owner of the forest

Forest management is not only the responsibility of families, villages and municipalities, but also of governments or global authorities. This is accepted by everyone, but in our reality, it seems like an empty slogan. The political or decision-making role of government, as responsible for managing the state, remains critical, moreover in the Decisions can increase negative impacts or create new national and versatile value. We are in a constant threat from an environmental disaster. The villagers are raising their voice and are organizing to protect the forest, asking the government to announce it a national park, as in the case of Shebenik and also during the proceedings of the assembly of the international land collision, which were held in Tirana last year. Many movies, articles and documentaries have been produce in order to document the losses in forests, and they have been followed by many threats by farmers, pastors ... Identified the impacts that governments, most of which are committed in principle to conservation and wise resource use, are themselves having on the forests under their stewardship through policies that inadvertently or intentionally aggravate the losses.

Page 1,2,3

Corresp. of "The Green Crown"

### The Associations of the Owners of Private Forests, contributing on the sustainable development of "Bjeshket e Namuna"

By Ardita DINAJ

Page 4

Some of the Associations of the Owners of Private Forests of the region Peje participated in the training held by the Environmental Organization ERA, within the program of alpine sustainable development, a program which is supported by SIDA-SNV.

In order to built the capacity of potential initiators and to increase knowledge and understanding of the practical implementation of the sustainable development initiatives in the rural and alpine areas, ERA developed a 5 days training program which was attended by the associations of Peje, Decan and Junik ...

## The woman in the rural areas and the forest

SNV, which now is a widely known organization in our country, during the implementation of their activities and in support of the National Federation of Communal Forests and Pastures, have tried to increase the participation and representation of the woman in the forest sector. Traditionally this sector have been dominated by men, but this is true only in the decision making process, because studies show that women are equally involved and give the same contribute. They collect firewood and medical plants, graze the cattle, make forest clearance, but they don't make decisions on these properties that they have traditionally held.

Several activities, aiming the women living in the rural areas empowerment and life improvement, have been undertaken within the project "Sustainable Strengthening of the Communal Forest II in Albania", funded by SIDA and implemented by SNV,

There have been published three articles about the activities organized in the framework of March 8<sup>th</sup> of this year from Shkodra (E. Sterkaj – S. Guri), Dibra (A. Sebi) and Kukesi (A. Aliaj)...

Page 6, 7



## The farmer's forest is owned by the farmer

By eng. Malvina SHEHI

After the publication of this article and the note by the head of the NACFP, Rexhep Ndreu, on the web has started a debate, in which specialist of the field and other experts share ideas, give opinions and discuss experiences. We are giving here a summary of the debate ...

Page 1, 3, 7



## Making decisions for sustainable forest management

Nijazi IDRIZI

member of the Parliament of Kosovo

Decision-making, as to all sectors, is estimated to be very important for the future of the forestry. It depends almost entirely from the data and from the possibility to transform them in information. The collection of data is very difficult in forestry because of the large woodland. Moreover, this data needs to be specified, not only according the characteristics of the forest products, but also according to their managing possibilities. This data are cross-sectional and include many actors which in many cases have different interests. t often happens that data on forests, due to different interests, are not favored to become information, and to produce effects, that are important for the society. Until now, the most completed documents with important data on forests regarding the sectional analysis are The National Forest Inventory (2003) and the long term management plans which are in the process...

Page 1, 5



## An experience from the Public Advisory Service in Albania

By Dr. Prof. Tatjana DISHNICA

Director of Information and Agricultural Advisory Service in the Ministry of Agriculture



farmers through regional structures.

In Albania, advisory services operate within a system with multiple stakeholders (public services, NGOs, donor funded projects, etc.). The public advisory service, in municipal level is organized and managed by the Directory of Information and Agricultural Advisory Service in the Ministry of Agriculture, which is responsible for the strategy, the management, the organization and the coordination of this service in all the country. This service offers advice and agricultural extension services to

12 sectors of the Advisory Service carry out their activity within the structure of DRB, in regional level. Three or four of the employers are profile specialists (in horticulture, plants protection, farming or agricultural economy) in accordance with the specification of every region. The total number of the employers is 269, of which 209 work in the field (120 in the agricultural information centers and 89 directly in the field). The agricultural information centers are distributed in the most important areas of agricultural production, in which an agricultural specialist operates ...

Page 1, 2

Kjo faqe u përkthye e u përgatit për botim nga Blerina KOLA

### KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Shqipëri dhe e Asosacionit të pronarëve Privatë, Kosovë

Këshilli Botues: A. Proko, N. Çollaku, V. Tabaku, J. Male, B. Gashi, I. Zeka, B. Hoxha

Kryeredaktor: AHMET OSJA Zv.kryeredaktorë: Nijazi IDRIZI, Ferdin LIÇAJ, Albora KACANI

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, M. Shehi. Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e ZP, kati II, Tiranë

Mobile: 068 40 75 975; e-mail: fkpkk@hotmail.com; velihoxha@yahoo.com

www.fkpkk.org

www.akppp.org

SNV  
Connecting People's Capacities

Sida